



Co-funded by
the European Union



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



DDA EKONOMIKE, KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE

ANALIZA E ZINXHIRIT TË VLERËS SË RICIKLIMIT NË KOSOVË

PRISHTINA, 2022



Informata mbi Hulumtimin

Ky publikim është prodhuar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) si pjesë e projektit “Përfshirja e ekonomisë qarkore në sektorin privat të Kosovës” i cili mbështetet nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH, si pjesë e projektit të ‘Shërbimeve të Qëndrueshme Komunale (Menaxhimi i Mbeturinave)’, i cili është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e GIZ-it dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe as të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Studimi është kryer nga Instituti për Ndërmarrësi dhe Biznese të Vogla (INBV) i përfaqësuar nga autori dhe eksperti kryesor Besnik Krasniqi, me kontributin e Muela Ibrahim (përfaqësuese e OEK), dhe eksperteve të projektit të Shërbimeve të Qëndrueshme Komunale në kuadër të GIZ Kosovë.

Përmbajtja

Informata mbi Hulumtimin	2
Lista e Tabelave	4
Lista e Figurave.....	4
Lista e Shkurtesave	5
Lista e definicioneve	6
Përmbledhja ekzekutive	6
1. Hyrje	8
2. Qëllimi dhe objektivat e studimit	10
3. Mbetjet dhe riciklimi i tyre në Kosovë	11
3.1. Shifrat në një shikim	12
3.2. Mjedisi institucional.....	13
3.3 Qëndrimet dhe veprimet kundrejt riciklimit.....	14
4. Metodologjia.....	15
4.1. Procedura.....	16
4.2 Mostra.....	16
3.3 Qasja analitike.....	19
5. Gjetjet nga Anketimi i Kompanive.....	19
6. Gjetjet e Anketës	21
6.1. Gjendja aktuale	21
6.2.1 Zinxhiri i vlerës për sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit në Kosovë	24
6.3 Zinxhiri i vlerave i firmave Kosovare: Dëshmi nga anketimi sasior	25
6.4 Potenciali dhe trendet e ardhshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit ..	32
7. Nevojat dhe barrierat e firmave ricikluese	35
7.1 Nevojat dhe barrierat: rezultatet e anketimit	37
8. Gjetjet për ekonominë qarkore.....	45
9. Rezultatet e gjetjeve të shoqatës së riciklimit.....	49
10. Gjetjet e grupit të fokusit	50

11.	Përfundimet, nënkuptimet dhe rekomandimet për politika	55
12.	Referencat	61
13.	Aneksi	65
a.	Aneksi 1: Anketa e riciklimit	65

Lista e Tabelave

Tabela 1: Përmbledhje e shifrave kryesore të sektorit të riciklimit në Kosovë.	12
Tabela 2: Statistikat përshkruese të mostrës	17
Tabela 3: Eksporti i mbetjeve dhe materialeve të riciklueshme për vit dhe kategori në Kosovë (në Euro)	20
Tabela 4: Numri total i punëtorëve për mostër për vit (me orar të plotë dhe gjysmë orar).....	23
Tabela 5: Sasia e materialeve të blera (në tonelata) gjatë viteve 2019-2021 dhe projeksionet e vëllimit për vitin 2022	33
Tabela 6: Përmbledhje e rezultateve na grupi i fokusit dhe implikimet e politikave	51

Lista e Figurave

Figura 1: Eksporti i mbetjeve dhe materialeve të riciklueshme në Kosovë 2010-2020.....	20
Figura 2: Firmat tatim-paguese aktive në vitin 2019 (N=175)	21
Figura 3: Mosha e firmave pjesëmarrëse	22
Figura 4: Ndryshimet e shitjeve brenda vitit të kaluar dhe përqindja e rritjes.....	24
Figura 5: Sektori i riciklimit në Kosovë: Paraqitja grafike e zinxhirit të vlerës	27
Figura 6: Zinxhiri i vlerës dhe përqindja e kompanisë për aktivitet.....	29
Figura 7: Tregjet në të cilat firmat shesin produktet/shërbimet e tyre (në përqindje).....	30
Figura 8: Kanalet e shitjes (në përqindje)	31
Figura 9: Mesatarja e përqindjes së shitjeve të përgjithshme nga eksporti.....	31
Figura 10: Ndarja e përqindjes së burimeve të mbetjeve (tani kundrejt tre vitet e ardhshme)	32
Figura 11: Investimet e kaluara dhe të ardhme.....	34
Figura 12: Përceptime për të ardhmen e sektorit dhe të kompanisë.....	35
Figura 13: Disponueshmëria e burimeve të afta njerëzore për të vepruar në tregun e riciklimit.....	35
Figura 14: Barrierat për zgjerim dhe rritje të biznesit	37
Figura 15: Barrierat për rritje dhe zhvillim nga aktiviteti.....	39
Figura 16: Barrierat për rritje dhe zhvillim për nga lloji i mbetjes së blerë	40
Figura 17: Ndryshimet në shitje dhe barrierat.....	41
Figura 18: Barrierat sipas madhësisë së kompanisë	42
Figura 19: Barrierat e moshës së kompanisë.....	43
Figura 20: Mbështetja nga donatorët.....	43
Figura 21: Mbështetja e donatorëve për rajon.....	44
Figura 22: Mbështetja e donatorëve dhe madhësia e kompanisë	44
Figura 23: Aplikimi i standardeve të kualitetit për mbrojtje të mjedisit.....	45
Figura 24: Shkalla e njohjes së konceptit të ekonomisë qarkore	46

Figura 25: Rëndësia e praktikave të ekonomisë qarkore në mbrojtjen e mjedisit	47
Figura 26: Shkalla e njohjes së ekonomisë qarkore dhe rëndësia e saj	47
Figura 27: Shkalla e njohjes së ekonomisë qarkore nga aktiviteti	48
Figura 28: Gatishmëria për t'u anëtarësuar në Shoqatën e Kompanive të Riciklimit.....	49
Figura 29: Llojet e mbështetjes që priten nga Oda Ekonomike e Kosovës (në përqindje)	50

Lista e Shkurtesave

KE – Konformiteti Evropian

PRE – Programi i Reformave Ekonomike

EU – Bashkimi Evropian

GIZ – Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

PEDL – Polietileni me Densitet të Lartë

INBV – Instituti për Ndërmarrësi dhe Biznese të Vogla

IPZH – Instituti për Politika Zhvillimore

QNQK – Certifikimi Ndërkombëtar për Qëndrueshmëri dhe Karbon

ONS – Organizata Ndërkombëtare për Standardizim

SIMM – Strategjia Integruese për Menaxhimin e Mbetjeve

OEK – Oda Ekonomike e Kosovës

AMMK – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

JZHQB – Java e Zhvillimi të Qëndrueshëm në Kosovë

PEDU – Polietileni me Densitet të Ulët

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

NVE – Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike

SKZH – Strategjia Kombëtare për Zhvillim

PET – Polietileni Tereftalat

KP - Klorid Polivinil

KSNT – Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë

TVSH- Taksa mbi Vlerën e Shtuar

ETP – Edukimi dhe Trajnimi Profesional

BP – Ballkani Perëndimor

Lista e definicioneve

Në këtë studim, termi 'kompani/firma' i referohet subjekteve që janë të angazhuara dhe operojnë përgjatë zinxhirit të vlerës së mbetjeve dhe riciklimit, përkatësisht në një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme: grumbullimin e mbetjeve; klasifikimin, përpunimin, riciklimin, dhe shitjen e mbetjeve.

Përmbledhja ekzekutive

Sipas raportit të fundit të Circularity Gab 2022, ekonomia botërore është qarkore vetëm 8.6 përqind, duke humbur 91.4 % nga gjithçka që përdorim (Ekonomia Qarkore, 2022). Popullsia në botë është në rritje dhe bashkë me të edhe kërkesa për lëndën e parë. Megjithatë, furnizimi me lëndë të parë thelbësore është i limituar duke treguar kështu që disa nga shtetet e Bashkimit Evropian janë të varura nga shtete të tjera për tu furnizuar me lëndë të parë (Parlamenti Evropian, 2021). Përveç kësaj, nxjerrja dhe përdorimi i lëndës së parë ka ndikim të madh në mjedis pasi që rrit përdorimin e energjisë dhe lirim të dioksidit të karbonit.

Ekonomia qarkore është një alternativë e qëndrueshme drejt modelit ekonomik linear tradicional (merr-bëj-sistemo) duke zvogëluar mbetjet në minimum duke i ripërdorur, riparuar, rinovuar dhe duke ricikluar materialet dhe produktet ekzistuese të cilat janë aspekte kyçe për ekonominë qarkore. Roli i riciklimit në modelin e ekonomisë qarkore është jashtëzakonisht i rëndësishëm: mbetjet e rikuperuara nga riciklimi rifuten në vetë sistemin e prodhimit, duke promovuar një zhvillim ekonomik më të balancuar dhe më të qëndrueshëm, në përputhshmëri me dashurinë për përkujdesje të mjedisit. Një sistem i duhur i menaxhimit të mbetjeve, i bazuar në hierarkinë e mbetjeve, ku mbetjet ndahen në burim, ku depozitimi i mbetjeve është alternativa më pak e preferuar, është themeli i një shoqërie më të qëndrueshme sepse ndihmon në përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së materialeve të ricikluara. (EY Global, 2021). Në thelb, ekonomia qarkore është një lak që kalon nga prodhimi, konsumi, menaxhimi i mbetjeve dhe rikthehet përsëri tek konsumi. Për shembull, përderisa familjet ndajnë më shumë mbetjet, kualiteti i materialeve të riciklueshme do të rritet dhe do të jetë më e mundur që prodhuesit të integrojnë ato në produktet e tyre. Kjo nga ana tjetër, do të kontribuojë në përmirësimin gjithëpërfshirës të produkteve të ricikluara, që do të thotë se më shumë materiale do të riciklohen gjatë gjithë ciklit.

Një model i ekonomisë qarkore, i cili do të përdorte jo vetëm menaxhimin e mbetjeve, por edhe reduktimin, ridizajnimin, ripërdorimin, riadaptimin, riciklimin si dhe prodhimin e përgjegjshëm, do të përkrahte zhvillimin e industrive të reja dhe punësimin, do të zvogëlonte emetimet dhe do të rriste përdorimin efikas të resurseve natyrale (duke përfshirë energjinë, ujin dhe materialet) (CSIRO, 2022). Konsumatorët gjithashtu do të pajisen me produkte më të qëndrueshme dhe më inovative të cilat do të i'u përmirësonin kualitetin e jetës dhe do të i'u kursenin para në plan afatgjatë. Për më tepër, të kaluarit në një ekonomi më qarkore mund të çojnë në tjera përfitime siç është mbrojtja e mjedisit, përmirësimi i sigurisë në furnizimin e lëndës së parë, rritja e konkurrueshmërisë dhe nxitja e inovacionit.

Ekonomia qarkore është një model industrial restaurues ose regjenerues për nga dizajni dhe qëllimi: produktet, komponentët dhe materialet mbahen gjithmonë në vlerën më të lartë të tyre. Deri më sot, koncepti i ekonomisë qarkore nuk është edhe aq i njohur dhe i pranuar në modelet e bizneseve të kompanive në sektorin privat të Kosovës.

Ekonomia qarkore është shumë e rëndësishme që të jetë e integruar në sektorin privat në mënyrë që të jetë në një rrjedhë me trendet globale. Aftësia e modelit tradicional linear për të paraqitur rritje ekonomike është duke u sfiduar gjithnjë e më shumë, si pasojë është shfaqur nevoja për të promovuar miratimin e qasjeve alternative të cilat mund të funksionojnë në periudhë afatgjatë. Faktor kyç për të ndërmarrë këtë ndryshim pozitiv është padyshim komuniteti i biznesit.

Për të pasur një pasqyrë më të përgjithshme të zinxhirit të vlerave dhe kompanive aktive në vend, ky studim ofron një sferë të gjerë të dhënash për gjendjen aktuale, nevojat, potencialin dhe barrierat e riciklimit. Duke u bazuar në të dhënat cilësore (diskutime në grupe fokusi) dhe sasore (analizë me kompani ricikluese) ky studim ofron implikime praktike të rëndësishme dhe rekomandime për politika për qeverinë, komunat, për organizatat donatore, shoqatat e bizneseve dhe kompanitë ricikluese.

Bazuar në të gjeturat kryesore të studimit, performanca e sektorit të riciklimit është shumë premtuese. Megjithatë, sektori i riciklimit përballë me disa pengesa që lidhen me pajisjet/makineritë, taksat, funksionimin e institucioneve, financimin dhe qasjen në fuqi punëtore të kualifikuar, të cilat vështirësojnë rritjen e firmave dhe eksportin.

Ky studim vë në pah nevojën e sektorit për të investuar në pajisje /makineri në të ardhmen e afërt. Bazuar në gjetje të studimeve, firmat e madhësive dhe eksperiencave të ndryshme në këtë fushë shprehin nevojën dhe qëllimin për investime në pajisje dhe makineri në të ardhmen. Ngaqë investimi kapital në makineri dhe pajisje është shumë i lartë në këtë sektor, atëherë shfaqet nevoja për financim.

Akciza me shtetet e tjera dhe ato fqinje paraqet një pengesë në zhvillimin dhe eksportin e këtij sektori. Prandaj, qeveria e Kosovës duke e përfshirë edhe rolin aktiv të OEK, duhet të gjejnë një formë subvencionimi të eksportit për të rritur konkurrueshmërinë në treg. Për më tepër, tatimi i mbajtur në burim në grumbullimin e mbetjeve është një tjetër pengesë që nuk është në linjë me praktikatat e Bashkimit Evropian dhe duhet të konsiderohet nga qeveria e Kosovës.

Për më shumë, qeveria dhe përfaqësuesit e bizneseve si OEK duhet të ndërmarrin rol udhëheqës për të lobuar në zgjidhjen e pengesave ndërkufitare dhe të konsiderojnë nxitjen e eksportit në këtë sektor. Përveç kësaj, kjo ngritë një çështje të rëndësishme për kompanitë e riciklimit për të organizuar dhe pasur një rol aktiv në lobim dhe përkrahje të politikave miqësore për sektorin e riciklimit, poashtu të ofrojë shërbime konsulence, mundësi rrjetëzimi, njohuri dhe trajnime për tema të ndryshme përfshirë edhe ekonominë qarkore.

Krejt në fund, për sa i përket financimit të kompanive të sektorit, gjetjet sugjerojnë se ekziston mungesë e përkrahjes qeveritare për sektorin e riciklimit, për këtë arsye Qeveria dhe donatorët duhet të punojnë bashkë në projektimin e planeve të financimit për të përkrahur investimin kapital në këtë sektor, i cili do të mbështesë tranzicionin drejt ekonomisë qarkore.

1. Hyrje

Komisioni Evropian miratoi planin e ri të veprimit të ekonomisë qarkore në Mars të vitit 2020. Plani i veprimit i ekonomisë qarkore ofron një agjendë të orientuar nga e ardhmja për të pasur një Evropë më të pastër dhe më konkurruese, duke bashkë krijuar me akterët ekonomik, konsumatorët, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (Komisioni Evropian, 2022). Qëllimi i ekonomisë qarkore është që të rrisë përdorimin e lëndës së parë, kështu që ato mund të përdoren, të ripërdoren,

riciklohen dhe te rikrijohen duke ulur efektet negative në mjedis. Ky sistem ekonomik synon eliminimin e mbetjeve dhe përdorimin më efikas të resurseve për prodhim. Thënë më thjeshtë, produktet që janë konsumuar dhe janë hedhur, janë risjellur në treg përmes riciklimit dhe ripërdorimit (Alkhateeb, Muñoz, Rohmah, Tang, & Walter, 2017).

Viteve të fundit, sektori privat në Kosovë ka qenë vazhdimisht në rritje duke u angazhuar në praktika të qëndrueshme mjedisore, duke iu bashkuar lëvizjes globale drejtë një mjedisi më ekologjik (USAID, 2021). Sipas Administrimit Tregtar Ndërkombëtar (ATN, 2021) të Shteteve të Bashkuara, menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi është një sektor atraktiv me të ardhme në Kosovë. Niveli i ulët i pjekurisë i karakterizuar me gjenerim në rritje të mbetjeve dhe mungesë e infrastrukturës së duhur krijon mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar siç janë kompanitë e Shteteve të Bashkuara për të ofruar shërbime të menaxhimit dhe riciklimit në Kosovë, duke përfshirë grumbullim, makineri, dhe pajisje bazë për menaxhim të mbetjeve.

Sipas Konsulencës së Andreas von Schoenberg (2021), investimi në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) ofron mundësi të mira biznesi përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës. Konkretisht, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë duke i rritur përpjekjet e tyre për të zvogëluar varësinë e tyre për deponi, për modernizimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve dhe harmonizimin e sistemit të tyre ligjor me atë të Bashkimit Evropian (BE). Gjithashtu, vetëdijesimi i këtyre vendeve për riciklimin është në rritje. Prandaj, këto zhvillime janë duke krijuar mundësi biznesi për kompanitë që merren me menaxhimin e mbetjeve, furnizuesit e pajisjeve, dhe kompanitë inxhinierike.

Sipas raportit të Kryeziut (2020), iniciativat e ekonomisë qarkore në Kosovë janë të përhapura në iniciativat e disa kompanive të sektorit privat, në diskutimet sipërfaqësore të organizatave joqeveritare dhe me vizion të pamjaftueshëm nga qeveria për të zhvilluar këtë sistem në vendin tonë. Në fakt, Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2021-2031, i referohet ekonomisë qarkore brenda shtyllës së saj të parë. SKZH e re është në pritje të miratimit nga Qeveria, ndërsa Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës (PREK) 2022-2024, është miratuar (Zyra e Kryeministrit, 2022).

Nisur nga çka përmendëm më sipër dhe duke marrë në konsideratë zbrazëtirën në përfaqësimin e kompanive të riciklimit në vend, OEK ka hyrë në një partneritet strategjik i cili synon integrimin

e ekonomisë qarkore në sektorin privat në Kosovë. Kjo iniciativë përkrahet nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SHGJBN) GmbH GIZ si pjesë e projektit të ‘Shërbime të Qëndrueshme Komunale’ (Menaxhimi i Mbetjeve) i cili është i vetë bashkë financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Kjo iniciativë përpiket të krijojë një komunitet praktik, me kompanitë ricikluese aktive në vend, ku çështja e ekonomisë qarkore mund të iniciohet dhe të zgjerohet edhe më shumë në të ardhmen e afërt. Konkretisht, ky studim ofron një pasqyrë të përgjithshme të zinxhirit të vlerës dhe kompanive aktive në vend, duke ofruar informacione rreth gjendjes aktuale, nevojave, potencialit, dhe barrierave të riciklimit. Ky studim bazë i riciklimit do të ndihmojë në përkrahjen e mëtejshme të potencialit të kompanive, adresimin e nevojave të tyre dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e sektorit të riciklimit në menaxhimin e mbetjeve, mjedis, dhe zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Pjesa kryesore e këtij raporti është strukturuar si në vijim. Fillimisht, është përshkruar qëllimi dhe objektivat e këtij studimi. Më pas, pjesa tjetër ofron një pasqyrë të përgjithshme të mbetjeve dhe riciklimit në Kosovë. Pastaj, studimi fokusohet në pasqyrën rreth sektorit dhe përshkruan shifrat e gjenerimit të mbetjeve, duke vazhduar me zinxhirin e vlerës dhe mjedisin institucional. Pas aspektit metodologjik, të gjeturat e studimit janë prezantuar dhe diskutuar. Krejt në fund, janë nxjerrë implikimet dhe rekomandimet për palët e interesit.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është që të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të sektorit të riciklimit në Kosovë me qëllim që të identifikohet potenciali për rritje dhe eksport dhe të jepen rekomandime për politika për palët e interesit të rëndësishme për integrimin e ekonomisë qarkore në Kosovë. Objektivi kryesor është të ndihmojmë në mbledhjen e të dhënave parësore dhe informatave të nevojshme të zinxhirit të vlerës të sektorit të riciklimit në vend:

1. Të kryhet një studim bazë i detajuar i zinxhirit të vlerës dhe kompanive ricikluese në Kosovë;
2. Të analizohet potenciali për zhvillim dhe barrierat e sektorit të riciklimit;

3. Të propozohen masat për politika dhe rekomandime të tjera për promovimin e zhvillimit të sektorit të riciklimit

3. Mbetjet dhe riciklimi i tyre në Kosovë

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK, 2021), riciklimi përbëhet nga çdo operacion përpunimi nga i cili mbetjet e materialeve i'u rikthehen produkteve, materialeve, dhe substancave ose si origjinale ose për qëllime të tjera. Kjo përfshinë përpunimin e materialeve organike por nuk përfshinë përpunimin e energjisë dhe ripërpunimin e materialeve që përdoren si lëndë djegëse ose për operacionet e mbulimit të mbetjeve.

Prodhimi i mbetjeve në BP ka qenë në rritje që nga viti 2003, megjithatë, shkalla e riciklimit është në nivele të ulëta, veçanërisht në Shqipëri dhe në Kosovë. Pavarësisht prezencës së industrisë së riciklimit, kompanitë ricikluese në këto vende nuk arrijnë të sigurojnë mjaftueshëm lëndë të parë kualitative nga tregu i brendshëm për të vepruar me kapacitete të plota (Forumi Ballkanik, 2021). Për këtë arsye, Komisioni Evropian sugjeron zhvillimin e një rrjeti të qendrave ricikluese në mënyrë që të rriten lehtësimet në riciklim si dhe të rritet numri i artikujve që përgatiten për ripërdorim. Kjo në shkëmbim do të rrisë shkallën e riciklimit dhe sasinë e materialit të riciklueshëm nën përgjegjësinë e prodhuesve dhe do të zvogëlojë ngarkesën financiare në sektorin publik.

Komunat dhe kompanitë e licencuara janë përgjegjëse për organizimin e grumbullimit të mbetjeve komunale në Kosovë. Në zona urbane mbetjet grumbullohen në pika të përbashkëta grumbullimi, ndërsa në zona rurale grumbullimi bëhet derë më derë. Progres i rëndësishëm është bërë në zgjerimin e mbulimit të shërbimeve të grumbullimit në Kosovë, i cili raportohet të jetë më shumë se 80% e popullsisë që nga viti 2019, kështu duke plotësuar targetin e propozuar për vitin 2021, por jo 100% (Agjencia Evropiane e Mjedisit, 2021).

Në Kosovë, ekzistojnë shtatë kompani publike të cilat grumbullojnë mbetjet dhe i transportojnë ato në deponi sanitare. Megjithatë, jo i gjithë territori është i mbuluar me shërbime të grumbullimit të mbetjeve, veçanërisht zonat e thella rurale. Kjo, së bashku me mungesën e kapaciteteve zbatuese dhe ndërjegjësimin e ulët, ka çuar në krijimin e 1,189 deponive ilegale në mbarë vendin, sipas të dhënave të raportuara për vitin 2020 (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2020)

3.1. Shifrat në një shikim

Tabela 1 përmbledh karakteristikat e sektorit të riciklimit në Kosovë. Kosova raportoi rritje me mbi 40% në trajtimin total të mbetjeve të ngurta komunale nga viti 2015 deri në vitin 2019, e cila kryesisht mund të ndërlidhet me rritjen e përqindjes së popullsisë me shërbimet e grumbullimit të mbetjeve (Agjencia Evropiane e Mjedisit, 2021). Kjo konsiston me 178 kg për banor në vitin 2015 dhe 234 kg për banor në vitin 2019. Pavarësisht kësaj, rritja e mbetjeve për banor në vitin 2020 ishte 272 kg (KEPA, 2022).

Tabela 1: Përmbledhje e shifrave kryesore të sektorit të riciklimit në Kosovë.

Aspektet	Shifrat	Burimi
Mbetjet e përziera komunale totale të grumbulluara	430,145 ton/vit	KEPA (2022- të dhënat e raportuara në 2020)
Mbetjet e gjeneruara për banorë	271.67 kg	KEPA (2022, të dhënat e raportuara në 2020))
Mbetje të riciklueshme	32%	KOSID (2017)
Përqindja e familjeve me akses në infrastrukturën e ndarjes së mbetjeve	5%	KEPA (2022 - të dhënat e raportuara në 2020)
Përbërja e mbetjeve të ricikluara	Metalet e Hekurit dhe metalet e tjera (69%) Mbetjet plastike (13%) Mbetjet e letrës dhe kartoni (14%)	KEPA (2020)
Mbetjet e eksportuara	2.6%	KEPA (2018)
Eksporti i mbetjeve të riciklueshme	52.1 milion Euro	ASK (2020)
Grumbullimi i mbetjeve	Kompanitë publike Kompanitë private të licencuara (~70) Mbledhësit joformal të mbetjeve (~2000)	Zyra Evropiane e Mjedisit (2020) KEPA (2018) Agjencia Evropiane e Mjedisit (2021)

Mohim përgjegjësie: Të dhënat e fundit zyrtare të publikuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (KEPA) janë prezantuar për shumicën e kategorive. Nëse të dhënat nuk janë përfshirë në raportin e fundit të publikuar për periudhën 2020, janë bërë referenca në raportet e mëparshme ose burime të tjera.

Që nga viti 2020 është vlerësuar se shuma totale e mbetjeve komunale të krijuara në mbarë vendin është 430,145 ton në vit (KEPA, 2022). Për sa i përket riciklimit, të dhënat nga viti 2017 kanë

treguar se 32% e grumbullimit të mbetjeve në Kosovë janë të riciklueshme (KOSID, 2017). Megjithatë, vetëm rreth 5% e familjeve kanë akses në infrastrukturën e ndarjes së mbetjeve (KEPA, 2020). Kjo është shumë larg nga targeti 50% i vendosur nga BE në zvogëlimin e mbetjeve të krijuara dhe inkurajimin e riciklimit. Për sa i përket përbërjes së mbetjeve të ricikluara, 69% të saj janë mbetje nga metalet e hekurit dhe metalet e tjera, 13% janë mbetje të plastikës, dhe 14% janë mbetje nga letra dhe kartoni (KEPA, 2020). Të dhënat e fundit të publikuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin raportues 2020 nuk japin informacion për përbërjen e mbeturinave dhe as për sasinë e mbetjeve të ricikluara. Megjithatë, në vitin 2019, janë identifikuar disa iniciativa për riciklimin e qelqit.

Kompanitë e riciklimit të mbetjeve në Kosovë, kryesisht riciklojnë letër, metale, bateri, kanaçe, lëndë organike, gomë dhe plastikë (Kryeziu, 2020). Në fakt, këto kompani janë vazhdimisht duke gjetur zgjidhje fitimprurëse për problemin e dukshëm të mbetjeve në vend. Disa kompani kanë gjetur mënyra të riciklimit të mbetjeve të Kosovës duke i kthyer ato në produkte të dobishme për përdorim të përditshëm dhe një numër i konsiderueshëm i tyre eksportohen gjerësisht. Mbetjet e letrës dhe plastikës riciklohen dhe kryesisht përdoren si fleta metalike për nivelim; letra e ricikluar është duke gjetur forma që të përdoret për ambalazhim letre dhe letër tualeti; riciklimi i qelqit është orientuar në pllaka xhami mozaiku mirëpo në sasi të limituar (Kabashi, 2021).

Raporti gjithëpërfshirës nga Alkhateeb, Muñoz, Rohmah, Tang, dhe Walter (2017), zbulon llojet e përdorura të plastikës dhe produktin final të plastikës në Kosovë. Llojet e plastikës që përdoren në industrinë e riciklimit: Polietileni me densitet të lartë (PEDL), polietileni me densitet të ulët (PEDU), dhe klorid polivinil (KPV). Ndërsa produktet më të rëndësishme të prodhuara nga to janë fletat metalike për agrokulturë dhe ndërtim, gypat për drenazh, çantat e shoppingut, shishet, kontejnerët, tapat e shisheve, fleta termosë për mbështjellje.

3.2. Mjedisi institucional

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është organi kryesor përgjegjës në nivelin qendror të Qeverisë për përcaktimin e kornizës strategjike, përcaktimin e politikave dhe ligjeve për rregullimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Ndërkohë, komunat kanë kompetenca ekskluzive për organizimin dhe menaxhimin e mbetjeve komunale brenda territoreve të tyre përkatëse.

Sipas KEPA (2018), qeveria e Kosovës është e vetëdijshme për përfitimet ekonomike dhe kursimin e potencialit të buxhetit shtetëror që do përfitohet nga zhvillimi i sektorit të riciklimit. Megjithatë, deri tani, investimet në industrinë e riciklimit në sektorin privat dhe atë publik kryesisht mbesin të planifikuara por të pazbatueshme dhe jo funksionale.

Strategjia e Kosovës për Menaxhim të Integruar të Mbetjeve (SKMIM) është në komponent integruar i kornizës strategjike dhe dokumenti kryesor për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve në Kosovë. Ai vendos objektivat strategjike, objektivat specifike, targetet dhe treguesit për menaxhim të mbetjeve, duke përfshirë këtu edhe riciklimin. Strategjia e re e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve SKMIM për vitet 2021-2030 u aprovua në Maj të vitit 2021, duke përfshirë një plan veprimi 3 vjeçar. Kjo Strategji është një moment historik i rëndësishëm për modernizimin e sektorit të menaxhimit të mbetjeve dhe kalimin nga shërbimet bazë drejt ekonomisë qarkore. Strategjia synon të krijojë një gjeneratë të re të infrastrukturës dhe shërbimeve të integruara të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, duke promovuar gjithashtu vlerat e ekonomisë qarkore dhe profesionalizimin e sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Si objektiv specifike, Strategjia synon të krijojë një kod industrial për sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit në statistikat kombëtare. Plani i veprimit trevjeçar parashikon masa ambicioze, zbatimi i të cilave kërkon kapital të lartë investimi dhe ekspertizë teknike.

Nga komunat kërkohet që të harmonizojnë planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve komunale me kornizën strategjike kombëtare dhe kornizën ligjore. Megjithatë, shumica e komunave duhet t'i nënshtrohen procesit të rishikimit të planeve të tyre pasi shumë prej tyre kanë skaduar. Në vitin 2020, 31 komuna kanë zhvilluar dhe aprovuar Planin Komunal për Menaxhim të Mbetjeve siç kërkohet me ligj (KEPA, 2020). Sipas SKMIM -së, përputhshmëria e përgjithshme e komunave me proceset e menaxhimit të mbeturinave dhe planifikimit ligjor (p.sh. zhvillimi dhe miratimi i planeve komunale dhe rregulloreve përkatëse, punësimi i zyrtarëve për menaxhimin e mbeturinave dhe inspektorëve mjedisor, kontraktimi i operatorëve të licencuar, shërbimet e mbledhjes së tarifave, gjatë e detyrueshme etj.) është rreth 69.4%.

3.3 Qëndrimet dhe veprimet kundrejt riciklimit

Viteve të fundit, është shfaqur një interesim më i madh në promovimin e riciklimit në Kosovë, veçanërisht nga aksione të iniciuara nga të huajt (INDEP, 2018). Për shembull, USAID mbështeti

tri kompani për të ricikluar mbetjet si produkte të dobishme të cilat tani po eksportohen dhe po hapin vende të reja pune (USAID, 2018). Specifikisht, Tiki Mozaik grumbullon mbetje të qelqit nga e gjithë Kosova dhe i riciklon ato në pllaka mozaiku; Izolimi Plast riciklon mbetje të plastikës dhe i përdorë ato si material izolues; AL-TEC është biznes i ri, i pari në Kosovë për riciklim të mishit dhe për prodhim të ushqimit për kafshë.

Për sa i përket fushatave zyrtare të vazhdueshme dhe të planifikuara për të rritur klasifikimin dhe riciklimin e mbetjeve, ka qenë një angazhim zyrtar nën aksionin "Ta pastrojmë Kosovën ", e kryer nga një organizatë joqeveritare në vitin 2018, për të pastruar deponitë jo të ligjshme (Agjencia Evropiane e Mjedisit, 2021). Për më tepër, GIZ, si pjesë e programit të tij që mbështet komunatë për të krijuar shërbime bazë të qëndrueshme dhe kalimin drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, ka pilotuar ndarjen në burim të mbetjeve të riciklueshme në disa komuna dhe ka mbështetur praktikatat e kompostimit në shtëpi. Organizata Qendra e Gjelbër e Artit- Prishtinë, me përkrahjen e GIZ Kosova udhëhoqi një fushatë vetëdijesimi në shtatë komuna të Kosovës me fokus përmirësimin e shërbimeve komunale të mbetjeve dhe promovimin e ndarjen e mbetjeve në burim.

Festivali i Gjelbër i Kosovës, i themeluar nga USAID në vitin 2016, dhe i udhëhequr tani nga sektori privat, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e teknologjive të gjelbërta dhe prodhimin e materialeve të qëndrueshme, duke mbështetur bizneset e gjelbëra për të krijuar lidhje tregu dhe për të rritur shitjet (USAID, 2021). Ngjashëm, qeveria e Kosovës së bashku me komunitetin ndërkombëtar dhe shoqërinë civile (specifikisht Ministria e Mjedisit e përkrahur nga qeveria Gjermane dhe Bashkimi Evropian) përmes GIZ-it organizojnë Javën e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë (JZHQK), një konferencë vjetore e nivelit të lartë me qëllim që të fillojnë një diskutim publik dhe të kërkojnë mënyra efektive për të promovuar zhvillim të qëndrueshëm duke përkrahur zhvillimin e gjelbër ekonomik. Në të kaluarën temat kanë përfshirë dekarbonizimin, ndryshimin klimatik, tranzicionin energjetik, prodhimin e energjisë, ekonominë qarkore, planifikimin urbanistik, e të tjera.

4. Metodologjia

Ky studim përdor mbledhjen dhe analizën e të dhënave cilësore dhe sasiore. Studimi cilësor përfshinë të dhëna nga diskutime me grupe fokusi me kompanitë e riciklimit. Tema e barrierave që ata hasin dhe potenciali për zhvillimin e sektorit të riciklimit është subjekt i analizës së kornizës

tematike dhe qasja e saj bazë është cilësore, sepse duhet të ofrojë vështrim të thellë të çështjeve përkatëse dhe gjithashtu arsyetim pas përshkrimeve të tij, si dhe rekomandime të propozuara për përmirësim. Analiza sasiore e të dhënave të studimit përmes hulumtimit parësor është përdorur vetëm për të shqyrtuar çështjet e identifikuar në grupe fokusi të një mostre më të madhe të kompanive. Përgjatë mbledhjes së të dhënave është ofruar përpunimi bazë cilësor i të dhënave, përmes klasifikimit dhe kategorizimit të temave dhe pikave (njësitë tematike) që të jenë të përshatshme pastaj për korrigjim dhe analizë. Analiza e të dhënave fokusohet në çështjet kryesore të studimit me qëllim të integritetit dhe koherencës së kornizës tematike. Analiza sasiore është e bazuar në analizë duke përdorur programin statistikor SPSS dhe duke prodhuar tabela të kryqëzuara për fenomene specifike. Ajo që vijon është prezantimi i të dhënave të anketimit të bazuara fillimisht në analizën sasiore të të dhënave dhe pastaj kalimi në gjetjet e diskutimeve të grupit të fokusit.

4.1. Procedura

Ekipi anketues i stafit të OEK ishin përfshirë në mbajtjen e intervistave ballë për ballë duke përdorur një platformë online për dizajnim të sondazheve të quajtur Qualtrics. Trajnim njëditor me stafin e angazhuar të anketuesve është mbajtur në mënyrë që të sigurohet kuptimi i dizajnit të pyetësorit dhe çështjeve teknike të punës me Qualtrics. Softueri lejon menaxhimin dhe zhvendosjen e të dhënave në programe softuerike të tjera sikurse Excel ose SPSS, të cilat përdoren për analizë të të dhënave.

Mostra për anketën me ndërmarrje është realizuar në më shumë se 100 kompani në të gjithë zinxhirin e vlerës së sektorit të riciklimit. Megjithatë, vetëm 68 kompani iu përgjigjën plotësisht pyetësorit. Mostra është zgjedhur në mënyrë rastësore nga lista e operuesve/kompanive të licencuara për menaxhimin e mbetjeve në Kosovë e siguruar nga MMPHI dhe e plotësuar me listën e kompanive të anëtarësuara në shoqatën e riciklimit të OEK, duke përdorur nën sektorët e NACE Rev.2 me objekt specifik sektorët e mbetjeve dhe riciklimit.

4.2 Mostra

Tabela 2 tregon statistika përshkruese të mostrës së të gjitha variablave të interesit. Shumica e të anketuarve janë pronar të kompanive ose menaxher të përgjithshëm (më shumë se 80 %) duke treguar kështu besueshmëri të lartë të të dhënave pasi që këto dy kategori janë më të informuarit

për kompanitë. Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë diplomë universitare ose kanë arsimim të mesëm të përgjithshëm ose kanë kryer shkollën për aftësim dhe formim profesional (VET). Shumica e kompanive janë mikro dhe të vogla (82.3%) nga regjioni i Prishtinës (39.1%) të cilat kanë vepruar mesatarisht për më shumë se 10 vjet (75.4%) më së shumti nga i njëjti vend (32.3%).

Tabela 2: Statistikat përshkruese të mostrës

	Shkalla	Përqindja
Pozita në organizatë		
Sipërmarrës/pronar	32	50.0
Menaxher (CEO)	20	31.3
Menaxher i burimeve njerëzore	1	1.6
Të tjerë	11	17.2
Edukimi		
Më pak se edukimi fillor	2	3.1
Shkollimi fillor	2	3.1
I mesëm i përgjithshëm	10	15.6
I mesëm profesional (VET)	7	10.9
Diplomë universitare	43	67.2
Mosha e firmës		
Më pak se 5 vjet	6	9.2
5-9 vjet	10	15.4
10-19 vjet	24	36.9
20+ vjet	25	38.5
Madhësia (numri i punëtorëve)		
Ndërmarrje mikro	33	41.8
Ndërmarrje e vogël	32	40.5
Ndërmarrje e mesme	13	17.7
Rajoni		
Ferizaj	6	9.4
Gjakovë	4	6.3
Gjilan	8	12.5
Mitrovicë	7	10.9
Pejë	5	7.8
Prishtinë	25	39.1
Prizren	9	14.1

Numri i vendeve të veprimit		
1 lokacion	21	32.3
2 lokacione	16	24.6
3-5 lokacione	15	20.0
Më shumë se 5 lokacione	65	23.1

3.3 Qasja analitike

Strategjia hulumtuese e përdorur në këtë studim është kombinim i metodave cilësore dhe sasiore. Aspekti cilësor përbëhet nga hulumtimi sekondar dhe intervistat me grupe fokusi me kompanitë dhe palët e interesuara. Hulumtimi sekondar përfshinë rishikimin e literaturës, rishikimin e të dhënave sekondare duke përfshirë këtu dokumentet e projektit, vlerësimet dhe studimet e mëhershme. Rishikimi i literaturës është kryer rreth trendëve të sektorit të mbetjeve dhe të riciklimit në Kosovë, dhe përtej saj. Rishikimi i të dhënave kombëtare strategjike dhe zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës që ofron të dhëna që përshkruajnë sektorin e riciklimit në Kosovë. Këto studime të rëndësishme janë rishikuar me shumë kujdes për të krijuar qasjen analitike dhe metodologjike të këtij studimi dhe për tu siguruar që është përdorur metodologjia më e përshtatshme për të vlerësuar potencialin e sektorit të riciklimit në Kosovë.


Metodologjia (Analiza e të dhënave për intervistat gjysmë të strukturuar) është kryer në disa hapa. Hapi i parë ishte mbledhja e të gjitha raporteve që lidheshin me sektorin e riciklimit në Kosovë. Më pas, mbajtëm një grup të fokusit me kompanitë e riciklimit dhe intervista gjysmë të strukturuar me palët e interesit, brenda kësaj faze, janë krahasuar dhe kundërshtuar gjetjet e literaturës. Pyetësi për analizën sasiore është dizajnuar duke u bazuar në temat e reja që u shfaqën nga grupi i fokusit dhe intervistat gjysmë të strukturuar.

5. Gjetjet nga Anketimi i Kompanive

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbetjet totale të eksportuara në vitin 2020 arritën në 52.1 milion Euro. Bazuar në Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Tregtisë (KSNT), kjo sasi përfshinë gomë të papërpunuar, masë të butë dhe letra të përdorura, xehe metalferike, copëza metalike dhe plastika në forma primare. Megjithatë, të dhënat tregojnë rënie në volumnin e eksportit

nga viti 2017 kur eksporti arriti kulmin me 77.2 milion Euro. Figura 1 sqaron këtë trend, ndërsa të dhënat të plota prezantohen në Tabelën 3 më poshtë.

Figura 1: Eksporti i mbetjeve dhe materialeve të riciklueshme në Kosovë 2010-2020.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Tabela 3: Eksporti i mbetjeve dhe materialeve të riciklueshme për vit dhe kategori në Kosovë (në Euro)

Viti	Goma e papërpunuar (Përf. Artif. dhe të rikuperuara)	Masa e butë dhe letra e përdorur	Xehet metalferike dhe copëzat metalike	Plastika në forma primare	Totali
2010	0	238,258	62,886,203	272,882	63,397,342
2011	34	721,309	66,722,939	588,770	68,033,052
2012	10,184	820,146	63,541,266	757,615	65,129,211
2013	1,627	800,999	58,358,493	843,934	60,005,053
2014	3,604	1,560,567	61,757,340	1,166,550	64,488,061
2015	1,150	1,515,696	39,411,117	992,033	41,919,996
2016	335	2,058,991	50,636,223	1,086,726	53,782,275
2017	6,400	2,458,440	73,317,565	1,387,245	77,169,649
2018	0	2,550,694	66,748,108	1,224,329	70,523,131
2019	199	2,006,021	57,350,638	1,716,586	61,073,443
2020	1,800	1,470,046	48,944,567	1,637,233	52,053,646

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në vitin 2019, ekzistonin 175 firma aktive në sektorin e mbetjeve dhe riciklimit (Figura 2). Lista mbizotërohet me tregtia me shumicë e mbetjeve dhe copëzave metalike (22%), duke u pasuar nga grumbullimi i mbetjeve jo të rrezikshme (19%), grumbullimi mbetjeve të rrezikshme (18%), prodhimi plastikës në formën primare (15%), trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme (11%), aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbetjeve (7%), çmontimi i hekurishteve (6%) dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme (1%).

Figura 2: Firmat tatim-paguese aktive në vitin 2019 (N=175)



Burimi: Oda Ekonomike e Kosovës

6. Gjetjet e Anketës

6.1. Gjendja aktuale

Firmat pjesëmarrëse varionin në bazë të viteve të veprimit prej nga ato me më pak se 5 vjet deri tek ato me më shumë se 20 vjet veprimi (Figura 3). Shumica e organizatave që janë përgjigjur (76%) kishin 10 vjet ose më shumë që operonin. Firmat e tjera kanë qenë duke operuar për 5-9 vjet (15%) dhe ato me më pak se 5 vjet (9%). Duke marrë për bazë numrin e punëtorëve (Tabela 4) dhe moshën (Figura 3), kompanitë në këtë sektor të industrisë, tentojnë të bëhen më të mëdha, me më shumë vite veprimi dhe më stabile. Kjo nënkupton se riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve

është pjekur si sektor pasi ka kaluar fazat e nevojshme të zhvillimit të kësaj industrie dhe ekziston potencial për rritje të mëtutjeshme gjithashtu.




Figura 3: Moshja e firmave pjesëmarrëse

Rezultatet tregojnë se gjatë vitit 2019, numri i përgjithshëm i punëtorëve (me orar të plotë dhe gjysmë orar) ishte 2,932 dhe shkalla e rritjes vjetore ishte 10% gjatë vitit 2022 ose rreth 3,932 punëtor në total. Ndërsa në tre vitet e ardhshme pritet një rritje prej përafërsisht 17% në numrin e punëtorëve. Këto të dhëna tregojnë potencial të rritjes së këtij sektori gjatë viteve dhe sugjerojnë mundësi të rritjes së punësimit dhe eksportit në të ardhmen. Tabela 4 i jep detajet e plota.

Numri në rritje i punëtorëve nënkupton potencial të rritjes së këtij sektori gjatë viteve në vijim. Pasi kompanitë janë duke planifikuar zgjerimin e planeve të tyre të veprimit dhe investimit, kjo tregon që numri i fuqisë punëtore pritet të ketë rritje gjithashtu. Me fjalë të tjera, do të kërkoheshin punëtorë shtesë në linjat e reja të prodhimit ose operatorë teknik për të vepruar me makineritë dhe pajisjet e reja.


Tabela 4: Numri total i punëtorëve për mostër për vit (me orar të plotë dhe gjysmë orar)

	Nr. i punëtorëve 2019	Nr. i punëtorëve 2022	Numri i pritur i punëtorëve për 3 vitet e ardhshme (në total)	Rritja në punësim 2019-2022 (në %)	Rritja e pritur e punësimit në 3 vitet e ardhshme (në %)
Punëtorët me orar të plotë	2747	3009	3528	10%	17%
Punëtorët me gjysmë orar/ sezonal	185	206	308	11%	50%
Totali	2932	3215	3836	10%	19%

Përdorimi i kapaciteteve është 52% ndërsa kapaciteti aktual i prodhimit në muaj është 8.847 ton. Nëse përdorimi i kapaciteteve rritet në 100%, kapaciteti i prodhimit do të jetë 17,013 në muaj dhe 204,156 në vit. Arsyeja pse nuk përdoret kapaciteti i brendshëm plotësisht mund t'i atribuohet shumë faktorëve, megjithatë pajisjet dhe makineritë mund të jenë një nga shumë arsyet. Kjo mbështetet nga të dhënat e anketimit të cilat tregojnë se pajisjet dhe makineritë janë barrierat më të mëdha me të cilat kompanitë përballen. Nga ana tjetër, kjo mund të ketë një efekt të dëmshëm në shfrytëzimin e kapaciteteve gjithashtu.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (63%) treguan që shitjet e tyre patën rritje brenda vitit të kaluar. Ndërsa, përkatësisht 27% dhe 11% e të anketuarve nuk deklaruan ndryshim në nivel të shitjeve ose rënie të nivelit. Rritja mesatare e shitjeve është raportuar të jetë 23%.

Figura 4: Ndryshimet e shitjeve brenda vitit të kaluar dhe përqindja e rritjes



6.2.1 Zinxhiri i vlerës për sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit në Kosovë

Analiza e zinxhirit të vlerës është një mjet i dobishëm i cili ofron një pasqyrë të pastër të aktiviteteve të bizneseve të cilat kryhen në faza të ndryshme; lejon identifikimin e aktiviteteve të cilat i shtojnë vlerë dhe janë më fitimprurëse se tjerat; iu ofron firmave udhëheqëse të kenë diferenca të fuqisë ndërmjet akterëve në zinxhir (Schmitz, 2005). Menaxhimi i mbetjeve në Kosovë kalon në tri faza kryesore. (Alkhateeb, Muñoz, Rohmah, Tang, & Walter, 2017). Fillimisht, në fazën e gjenerimit të mbetjeve, shtëpitë dhe bizneset private paguajnë 3-5 Euro në muaj si tarifë të grumbullimit të mbetjeve. Në fazën e dytë, mbetjet e riciklueshme grumbullohen nga grumbulluesit individual të mbetjeve të cilët i shesin mbetjet tek ndërmjetësit ose tek kompanitë e riciklimit ose përdorin mjetet e klasifikimit. Dhe në fund, mbetjet klasifikohen dhe transferohen për përpunim në kompanitë e riciklimit. Sipas KEPA (2018), ekzistojnë rreth 70 biznese të licencuara të cilat procesojnë të materialet e riciklueshme të grumbulluara dhe i eksportojnë ato.

Kompanitë private të angazhuara në grumbullimin e mbetjeve, menaxhimin, përpunimin e të blerave të pandara, mbetjet e papërpunuara, dhe gjëra të tjera me vlerë nga më shumë se një burim i mbetjeve. Këto kompani blejnë mbetje nga rrjete të supermarketeve, nga ndërmarrjet publike dhe

private, dhe gjithashtu nga grumbullues joformal të mbetjeve (ERAC, 2019). Pjesa më e madhe e mbetjeve të grumbulluara dhe të përpunuara nga kompanitë shitet si eksport. Përveç disa shufrave metalike, nuk ka kërkesë të madhe për lëndë të riciklueshme nga industria vendore (Agjencia Evropiane e Mjedisit, 2021).

Pavarësisht kësaj, Agjencia Evropiane e Mjedisit (2021) tregon që për momentin, vetëm një pjesë e vogël e mbetjeve riciklohet në Kosovë, pasi që kjo bëhet më së shumti nga grumbullues joformal të burimeve, për sasinë e tyre nuk ka ndonjë të dhënë zyrtare. Në fakt, grumbulluesit joformal luajnë rol të rëndësishëm në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme; është vlerësuar se 2000 individ mund të jenë të angazhuar individualisht në grumbullimin joformal në të gjithë Kosovën, mirëpo nuk ekzistojnë të dhëna ose matje për të vlerësuar nivelin e aktivitetit.

6.3 Zinxhiri i vlerave i firmave Kosovare: Dëshmi nga anketimi sasior


Spektori i analizës së zinxhirit të vlerave përfshin ekzaminimin e fazave të ndryshme të prodhimit të produktit, që nga burimi i lëndës së parë e deri tek blerja përfundimtare nga përdoruesit e fundit. Analiza e zinxhirit të vlerës është një mjet i dobishëm edhe për qëllime analitike dhe për qëllime të politikave. Bazuar në të dhënat origjinale të 68 firmave ricikluese, kjo pjesë përcakton dhe harton zinxhirin e vlerave në sektorin e riciklimit në Kosovë.

Figura 6 bazuar në të dhënat e anketës paraqet grafikisht hartën e zinxhirit të vlerës. Ai paraqet hapat dhe akteret e ndryshëm dhe lejon që të kuptohet qartë lidhja që kanë në mes vete. Zinxhiri i vlerës i firmave ricikluese në Kosovë përbëhet nga katër hapa të rëndësishëm: grumbullimi i mbetjeve, klasifikimi i tyre, përpunimi dhe shitja. Nga pika e krijimit të mbetjeve dhe eventualisht ripërdorimi i tyre si pjesë e produkteve të reja të krijuara, kryhen disa veprime komplekse të përpunimit dhe konvertimit të materialeve të cilat kalojnë në pronësi të ndryshme para se të kthehen në produkte të reja apo të kthehen në treg për konsumatorët.

Rezultatet e anketës tregojnë një shpërndarje jo të barabartë të firmave përmes fazave të ndryshme të zinxhirit të vlerës. Siç shihet në figurën 6, pjesa më e madhe e kompanive ricikluese fokusohen në fazën e përpunimit të mbetjeve (38% e totalit të kompanive), me një numër relativisht të vogël

të kompanive që merren me grumbullimin e mbetjeve (30), klasifikimin (20%) dhe shitjen e tyre (12%).

Firmat furnizohen me lëndë të parë dhe të inpute nga burime të ndryshme. Ngjashëm, ata shesin produkte finale ose të përpunuara në nivel lokal ose i eksportojnë ato duke përdorur kanale të ndryshme të shitjeve. Një analizë më e thellë e secilit hap të zinxhirit të vlerës është dhënë më poshtë.




Bazuar në paraqitjen grafike të mësipërme, paraqitet një shtjellim më i detajuar i zinxhirit të vlerës në sektorin e riciklimit në Kosovë. Figura e 7 paraqet përqindjen e kompanive për aktivitet në sektorin e zinxhirit të vlerës. Në grumbullimin e mbetjeve, shumica e kompanive grumbullojnë mbetje nga sistemet e tyre të grumbullimit (30). Në fakt, ky është një rezultat premtues sepse të kesh 30% të firmave të cilat furnizohen nga pikat e tyre grumbulluese tregon investim thelbësor në këtë sektor. Për më tepër, më shumë se çereku i mbetjeve (26%) blehen nga sektori formal, duke nënkuptuar se sektori i riciklimit është duke bashkëpunuar me sektor të tjerë për të blerë mbetje dhe është kritik për të qar përpara këtë bashkëpunim. Në anën tjetër, përqindja e importit të mbetjeve është i ulët. Ndërlidhja me bashkëpunëtorët lokal siguron kohë më të shkurtër të prodhimit dhe dorëzimit, prodhim në kohë, dhe shmang kompleksitetin e marrëdhënieve me firmat që veprojnë jashtë shtetit, ose të taksave të importit.

Përderisa kompanitë mund të kenë investuar në infrastrukturën vetanake të grumbullimit, ky nuk është rasti i njëjtte me pajisjet e klasifikimit. Në fazën e dytë, këto kompani merren me klasifikimin e mbetjeve, e më së shumti me mbetjet e përziera të ndara në mënyre manuale. (37%). Ndarja manuale e ngritë çështjen e jo efikasitetit dhe shkakton rritje të kostos së fuqisë punëtore. Për këtë arsye, klasifikimi dhe automatizimi i mbetjeve është thelbësor nga teknologji të mençura për materiale të cilat klasifikojnë lloje të ndryshme të plastikës në procese të riciklimit. Një pjesë e madhe e kompanive (35%) varen nga ndarja në burim. Kjo mund të jetë një shenjë pozitive e rritjes së vetëdijesimit të individëve për ndarjen në burim, edhe pse është ende në një fazë fillestare. GIZ ka qenë i përfshirë në shumë pilot projekte përreth, për të promovuar ndarjen e materialeve nga lloji në pikën e hedhjes që të mund të riciklohen.

Për sa i përket fazës së tretë të përpunimit, kompanitë të cilat përpunojnë mbetjet, pak a shumë merren me të gjitha aktivitetet: depozitim dhe garanci (24%), pastrim (20%), thekim/copëtim (20%), riciklim (20%), dhe granulat (17%). Nga kjo shpërndarje e nën aktivitetëve, mund të vijmë në konkludim se nuk ka ndonjë aktivitet që tërheq më shumë vëmendje tek akterët e tregut që të fokusohen më shumë në të.

Figura 6: Zinxhiri i vlerës dhe përqindja e kompanisë për aktivitet




Së fundmi, kompanitë të cilat shesin, më së shumti depërtojnë në tregun vendas (60%) krahasuar me eksportin (40%). Këto të dhëna sugjerojnë për të bërë një analizë më të detajuar që ka të bëjë me tregjet në të cilat firmat i shesin produktet/shërbimet e tyre.

Rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e kompanive (55%) i shesin produktet e tyre në nivel lokal, 21% në vendet fqinje, 19% në vendet e Bashkimit Evropian, dhe 5% në tregjet e tjera. Gjetjet tregojnë se aktualisht, firmat ricikluese kosovare nuk janë shumë të orientuara drejt eksportit. Mungesa e orientimit në eksport mund të shpjgohet si mungesë e përdorimit të kapaciteteve të plota të brendshme dhe barrierave ekzistuese, të cilat më vonë do të shtjellohen më tej. Këta dy faktor nuk lejojnë të përmbushen kërkesat ndërkombëtare, kështu që kompanitë fokusohen në tregun vendor. Pavarësisht kësaj, qasja vendore e marketingut nuk është e dobishme për kompanitë në plan afatgjatë kryesisht për shkak të madhësisë së kufizuar të tregut dhe qasjes në lëndën e parë. Fokusi vetëm në tregun vendor përkthehet si caqe me fitime të ulëta, prandaj, zgjerimi i biznesit ndërkombëtarisht parashtron mundësi më të mëdha për të sjellë fitim, e veçanërisht nëse firmat janë të gatshme për t'i ndryshuar ofertat që ata kanë. Ngjashëm, në tregun vendor, qasja në lëndë të parë dhe fuqi punëtore mund të jetë e limituar. Për këtë arsye, në plan afatgjatë, firmat ricikluese

kosovare duhet të synojnë tregjet ndërkombëtare pasi që në këtë mënyrë ato mund të marrin më lehtë dhe më lirë lëndë të para dhe mund të ekspozohen ndaj know-how dhe ekspertizave të reja.


Figura 7: Tregjet në të cilat firmat shesin produktet/shërbimet e tyre (në përqindje)



Kompanitë ricikluese në Kosovë përdorin kanale të ndryshme të shitjeve. Ata shesin produktet e tyre finale me bazë riciklimi direkt tek prodhuesit në Kosovë (28%), direkt tek prodhuesit jashtë Kosovës (22%), në tregje me shumicë (21%), tjera lloje materialesh të mëdha tek tregtarët e ndërmjetëm (4%), materialet e riciklueshme të pa shitura vetëm me përpunim të brendshëm (11%), dhe të tjera (14%).


Me fjalë të tjera, shitja direkte (vendore ose ndërkombëtare) është një qasje dominante mes firmave të riciklimit në Kosovë. Nga njëra anë, shitja direkte zvogëlon shpenzimet e përgjithshme dhe ato të reklamimeve. Për më tepër, është një mënyrë efektive për të ndërtuar lidhje të gjata me konsumator pasi që konsumatorët përfitojnë nga komoditeti dhe vëmendja personale që marrin nga shitësit e drejtpërdrejtë. Megjithatë, shitja e drejtpërdrejtë kërkon përpjekje të mëdha për të ndërvepruar me konsumator dhe tërheqja e konsumatorëve të rinjë mund të jetë e vështirë. Prandaj, në plan më të gjatë kohor, firmat ricikluese në Kosovë mund të konsiderojnë përvetësimin e metodave jodirekte të shitjes, pra përmes ndërmjetësve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për t'u futur në tregjet e huaja ku njohuritë lokale janë thelbësore dhe transferimi jashtë i shitjeve mund të jetë një opsion i zbatueshëm.

Figura 8: Kanalet e shitjes (në përqindje)



Gjetjet tregojnë që ato kompani të cilat eksportojnë, mesatarisht 34% e shitjeve të përgjithshme të tyre fitohen nga eksporti.

Figura 9: Mesatarja e përqindjes së shitjeve të përgjithshme nga eksporti




Për kryerjen e një analize më të thellë të burimeve të mbetjeve, është paraqitur më poshtë një krahasim i cili tregon se si firmat aktualisht grumbullojnë mbetjet dhe cilat janë planet e tyre në tre vitet e ardhshme. Në të ardhmen, pritet të ketë rritje të infrastrukturës vetanake të grumbullimit (35%) dhe ndarjes së mbledhësve (27%) si burime të mbetjeve. Kjo nënkupton që një pjesë e madhe e kompanive në Kosovë janë të prirura për

investime në pajisje të brendshme në mënyrë që të përmirësojnë infrastrukturën e grumbullimit duke rritur besueshmërinë dhe fleksibilitetin e operacioneve. Mbështetja në rezervat e tyre të grumbullimit ofron kontroll në proceset dhe kapacitetet e pajisjeve dhe në menaxhimin e inventarit. Ndërsa, grumbulluesit komunal, prodhuesit industrial, tregtarët e mbeturinave, dhe importi do të kenë rënie krahasuar me gjendjen aktuale. Kjo mund të shpjegon tendencën e

kompanive për tu varur më pak në palën e tretë furnizuese duke zvogëluar mundësinë e mbajtjes së fuqisë negociuese.

Figura 10: Ndarja e përqindjes së burimeve të mbetjeve (tani kundrejt tre vitet e ardhshme)



6.4 Potenciali dhe trendet e ardhshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit

Duke u bazuar në të dhënat e pyetësorit tonë, numri i përgjithshëm i mbetjeve të blera në vitin 2021 arriti në 1,048,977 ton, ose 7% më pak se në vitin 2019 (1,129,050 ton) dhe 13% e planifikuar më pak për vitin 2022 (917,110 ton). Materialet e mbetjeve më të blera gjatë vitit 2021 ishin kartoni dhe letra (925,265 ton ose 82%), metali me ngjyra (51,857 ton ose 5%) dhe çeliku (51,520 ton ose 6%). Trend i ngjajshëm është vërejtur në planet e blerjeve për vitin 2022: karton dhe letër (805,500 ton ose 88%), metale me ngjyra (50,570 ton ose 6%) dhe çelik (51,520 ton ose 6%).

Sasia e mbetjeve organike të blera, PEDU, dhe çeliku janë rritur në vitin 2021 dhe pritet të kenë rritje edhe në vitin 2020. Mbetjet organike patën rritje 100% në vitin 2021 dhe planifikohet të kenë 11 % rritje në vitin 2022, PEDU pati rritje për 28% në vitin 2021 dhe planifikohet të ketë 22% rritje në vitin 2022, çeliku pati rritje 74 % në vitin 2021 dhe pritet të ketë 8% rritje në vitin 2022.

Ndërsa, një trend mjaftueshëm negativ është vënë re në sasinë e materialeve të blera të PET (-42 % në vitin 2021; -62 % në vitin 2022), plastika të përziera dhe/ose të tjera (-49 % në vitin 2021; -98 % në vitin 2022) dhe alumini (-17% në vitin 2021; -88% në vitin 2022). Përveç faktit që qarkullimi i PET në praktik është ende i lartë, ky trend negativ i blerjes së PET dhe materialeve të tjera të plastikës që tregon studimi mund të shpjegohet nga fakti që kompanitë blejnë nga sektori jo formal. Ndërsa, për sa i përket aluminit, përdorimi i tij veçanërisht për paketim të pijeve ka qenë në rënie (Calma, 2020).


Tabela 5: Sasia e materialeve të blera (në tonelata) gjatë viteve 2019-2021 dhe projeksionet e vëllimit për vitin 2022

Material (in tons)	Quantity 2019	Quantity 2021	% of increase 2021	Plans to purchase waste in 2022	% of increase 2022
Cardboard & paper	1,020,880	925,265	-9%	805,500	-13%
Non-ferrous metals	42,227	51,857	23%	50,570	-2%
Steel	27,391	47,636	74%	51,520	8%
Mixed &/or other plastics	30,435	15,456	-49%	270	-98%
Low density polyethylene (LDPE)	3,530	4,530	28%	5,540	22%
Aluminum	2,072	1,713	-17%	210	-88%
High density polyethylene (HDPE)	1,020	1,010	-1%	1,210	20%
Others	790	665	-16%	1,440	17%
Organic	250	500	100%	555	11%
Polypropylene	150	175	17%	170	-8%
Polyethylene terephthalate (PET)	155	90	-42%	35	-61%
Glass	130	50	-62%	70	40%
Polystyrene	20	30	50%	20	-33%
Electronic Waste	0	0		0	
Masonry	0	0		0	
Total	1,129,050	1,048,977	-7%	917,110	-13%

Duke marrë parasysh investimet e bëra në tre vitet e kaluara, më së shumti kompanitë kanë investuar në ndërtesa, në përmirësimin e linjave aktuale të prodhimit, dhe në linjat e reja të prodhimit. Ndërsa në tre vitet e ardhshme, ato planifikojnë të investojnë në pajisje/makineri, ndërtesa, linja të reja të produkteve, dhe gjithashtu në know-how. Nevoja e këtij sektori që vazhdimisht të investohet në kapacitetet e tyre mund të jetë si rezultat i trendit pozitiv të shitjeve. Siç u tregua më herët, 63% e kompanive u shprehen se shitjet e tyre u rritën brenda vitit të kaluar ndërsa rritja mesatare e shitjeve u raportua të jetë 23%. Për më tepër, duke marrë parasysh që 34% e portofolios së shitjeve vjen nga eksporti, mund të ekzistojë nevoja për investime dhe rritje të kualitetit të sistemeve/produkteve ekzistuese në mënyrë që të preken kërkesat e tregjeve të huaja. Vlen të theksohet se në të kaluarën asnjë nga të anketuarit nuk kanë investuar në know-how dhe


në pajisje/makineri dhe këto janë vetëm plane afatgjate. Duke marrë parasysh kërkesat e larta të teknologjisë së avancuar për të ecur drejt ekonomisë qarkore, investimet në know-how janë të domosdoshme. Investimet në teknologji të reja do të nxisin përparime inovative të cilat janë esenciale në modelin e ekonomisë qarkore, siç është riciklimi. Me fjalë të tjera, teknologjitë e reja do të mundësonin ndryshimin e modelit drejt ekonomisë së mundshme qarkore, pasi që ato ofrojnë mjete që janë në gjendje të ulin kostot, të automatizojnë detyrat, e madje edhe të krijojnë vlera ekonomike.

Figura 11: Investimet e kaluara dhe të ardhme




Jo çuditërisht, kompanitë të cilat presin rritje të sektorit në të cilin ata veprojnë, presin që shitjet e tyre të rriten gjithashtu.

Figura 12: Përceptime për të ardhmen e sektorit dhe të kompanisë



Pjesa më e madhe e mostrës konsiderojnë që kanë burime të mjaftueshme njerëzore të shkathëta për të vepruar në tregun e riciklimit. Rreth 35 % e firmave pajohen deri diku me këtë deklaratë ndërsa 29% pajtohen plotësisht.

Figura 13: Disponueshmëria e burimeve të afta njerëzore për të vepruar në tregun e riciklimit



7. Nevojat dhe barrierat e firmave ricikluese

Fillimisht, një barrierë e dukshme është mungesa e infrastrukturës së nevojshme për ndarje në burim. GIZ ka nisur disa pilot projekte në komuna të ndryshme, për të promovuar ndarjen e

materialeve nga lloji në pikën e hedhjes kështu që ato të mund të riciklohen. Megjithatë, përveç kompanive të licencuara të cilat eksportojnë materiale të riciklueshme, nuk ekziston ndonjë infrastrukturë adekuate e riciklimit për trajtim dhe përpunim të mëtejshëm.

Legjislacioni aktual i miratuar nuk e trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse konceptin e ekonomisë qarkore dhe, si rrjedhojë, e bën të vështirë zbatimin e këtij procesi në praktikë. Për këtë arsye, duhet të hartohet një legjislacion i ri për të siguruar përfshirje të koncepteve dhe terminologjive të përshtatshme të ekonomisë qarkore, duke u ofruar lehtësime personave, subjekteve (fitimprurëse dhe jo fitimprurëse) të cilat janë duke kontribuar ose që planifikojnë të kontribuojnë për të stimuluar ekonominë qarkore në vend (Gjoka, 2020).

Pengesat kryesore të cilat e ngadalësojnë zhvillimin e ekonomisë qarkore në Kosovë janë mungesa e vetëdijesimit publik për përfitimet që rrjedhin nga ekonomia qarkore, si dhe mungesa e përkrahjes financiare shtetërore e cila stimulon ekonominë qarkore në vend (Gjoka, 2020).


Hulumtimet sugjerojnë se komunitetet në Kosovë nuk janë të vetëdijshme për konceptin thelbësor të modelit të ekonomisë qarkore, rrugën drejt zhvillimit të tij, dhe përfitimet e përvetësimit të saj. Edhe pse ekziston një vullnet i përbashkët për mbrojtjen e ambientit, ekziston edhe mungesë e kuptimit të plotë se si veprimet e kompanive dhe ato individuale kontribuojnë drejt një ekzistence vazhdimisht e më të shëndetshme (Hapçiu, 2019). Mos njohja e terminologjisë, e vështirëson kuptimin e ekonomisë qarkore dhe gjithashtu komponentët ndërtues që mundësojnë zhvillimin e saj (Gjoka, 2020).

Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit (2021), qëndrueshmëria financiare e klasifikimit dhe riciklimit të bimëve është e kërcënuar nga aktivitetet e sektorit joformal. Domethënë, grumbulluesit joformal të burimeve luajnë një rol të rëndësishëm në grumbullimin e mbetjeve nëpër Kosovë; megjithatë, nuk ka të dhëna, ose matje zyrtare për sasinë e mbetjeve të grumbulluara në këtë mënyrë. Pasi që sektori jo formal ka funksionuar gjerësisht në menaxhimin e mbetjeve për disa vite tani, ata sjellin sfida të reja për sektorin formal. Për shembull, sektori joformal punon ngushtë me bizneset e vogla të cilat kërkojnë më shumë të fitojnë sesa t'i praktikojnë aktivitetet e tyre për hir të përfitimeve të mjedisit dhe puna e fëmijëve është shumë e shpeshtë, dhe kushtet e punës së tyre janë të pafavorshme dhe përfshijnë rrezik të lartë për jetën (INDEP, 2018).

7.1 Nevojat dhe barrierat: rezultatet e anketimit

Barrierat kryesore me të cilat ky sektor përballlet raportohet të jenë: pajisjet dhe makineritë (3.6), taksat (3.5), financat (3.5), korniza ligjore (3.2), barrierat ndërkufitare (3.0), dhe disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar (2.9) (1= nuk pajtohem aspak, 5= pajtohem plotësisht).

Figura 14: Barrierat për zgjerim dhe rritje të biznesit



Kompanitë që karakterizohen me rënie të shitjeve brenda viti të kaluar, sfidohen më së shumti me barrierat financiare (4.71), pajisje dhe makineri (4.57), dhe taksa (3.43). Në ato kompani në të cilat shitja ka mbetur e njëjtë, barrierat që kanë mbizotëruar ishin pajisje dhe makineritë (3.5), taksat (3.38) dhe disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar (3.07). Krejt në fund, kompanitë të cilat patën rritje të shitjeve, konsideruan taksat (3.61), kornizën ligjore (3.58), dhe pajisje dhe makineritë (3.42) si faktorët që kanë penguar më tepër në rritje dhe zhvillim.


Pastaj, barrierat që kompanitë hasin për rritje dhe zhvillim analizohen në bazë të fazës së zinxhirit të vlerës që përfshihet në aktivitetin e tyre.

Përgjithësisht, barrierat ndërkufitare dhe taksat janë barrierat më të shpeshta që kompanitë hasin. Bazuar në fazën e zinxhirit të vlerës që ato përfshihen, barrierat më të rëndësishme për kompanitë grumbulluese dhe shitëse janë barrierat ndërkufitare (doganat) (3.7 në të dyja rastet) ndërsa për kompanitë që klasifikojnë dhe përpunojnë janë taksat (3.5 dhe 3.6, respektivisht).

Pjesa e mëposhtme elaboron në detaje barrierat kryesore që kompanitë hasin sipas aktivitetit të tyre:

- **Blenë mbetje nga sektori joformal:** barrierat ndërkufitare (4.1), taksat (3.8), korniza ligjore (3.6) dhe pajisje dhe makineritë (3.6).
- **Blenë mbetje nga sektori formal:** pajisje dhe makineritë (3.6), korniza ligjore (3.5), taksat (3.5) dhe barrierat ndërkufitare (3.5).
- **Grumbullon mbetje nga qendrat\sisitemet vetë grumbulluese:** taksat (3.7), financat (3.6) dhe pajisje dhe makineritë (3.6).
- **Blenë mbetje nga jashtë Kosovës:** barrierat ndërkufitare (3.9), korniza ligjore (3.4) dhe taksat (3.3).
- **Blenë materiale të riciklueshme nga jashtë Kosovës :** barrierat ndërkufitare (4.0), korniza ligjore (3.4) dhe taksat (3.4).
- **Ndarje në burim:** taksat (3.7), (3.6), financat (3.4) dhe korniza ligjore (3.4).
- **Ndarja e mbetjeve të përziara në mënyrë manuale:** taksat (3.6), pajisje dhe makineritë (3.5), korniza ligjore (3.4) dhe barrierat ndërkufitare(3.4).
- **Makineritë e linjës së ndarjes së mbetjeve të përziara:** taksat (3.7), barrierat ndërkufitare (3.7), dhe korniza ligjore(3.4)
- **Pastrim:** taksat (3.6), korniza ligjore(3.4) dhe barrierat ndërkufitare (3.4).
- **Depozitim:** taksat (3.6) dhe korniza ligjore(3.3).
- **Thekim/copëtim:** taksat (3.5), pajisje dhe makineritë (3 .4), korniza ligjore(3.4), dhe barrierat ndërkufitare (3.4).
- **Granulat:** taksat (3.6), barrierat ndërkufitare (3.5), dhe korniza ligjore (3.2).
- **Riciklim:** pajisje dhe makineritë (3.5), korniza ligjore (3.5), taksat (3.5) barrierat ndërkufitare (3.5).
- **Tregu i brendshëm :** taksat (3.8), pajisje dhe makineritë (3.7) dhe financat (3.6).
- **Eksporti:** barrierat ndërkufitare (4.0), korniza ligjore (3.5), financat (3.3), dhe taksat (3.3).

Figura 15: Barrierat për rritje dhe zhvillim nga aktiviteti




Në mënyrë që të kuptojmë më mirë faktorët që pengojnë rritjen dhe zhvillimin e kompanive, janë analizuar barrierat që kanë të bëjnë me llojet e mbetjeve që kompanitë blejnë. Barrierat kryesore për kompanitë që blejnë mbetje letre dhe qelqi janë barrierat ndërkufitare (5.0 në të dyja rastet), për kompanitë që blejnë mbetje plastike dhe organike janë taksat (3.8 në të dyja rastet), për kompanitë që blejnë mbetje metali janë financat (4.1), dhe për kompanitë që blejnë mbetje të tjera janë pajisjet dhe makineritë (4.3).

Më poshtë janë të përmbledhura barrierat kryesore që hasin kompanitë duke u bazuar në llojin e mbetjeve:

- **Karton dhe letër:** barrierat ndërkufitare (5.0), dhe pajisje dhe makineritë (4.3).
- **Qelq:** pajisje dhe makineritë (5.0), financat (5.0), korniza ligjore (5.0), taksat (5.0), barrierat ndërkufitare (5.0).
- **Metalet me ngjyra :** financat (4.1), barrierat ndërkufitare (4.0), dhe taksat (3.9).
- **Çeliku:** financat (3.8), taksat (3.8), dhe barrierat ndërkufitare (3.7).
- **Alumini:** financat (4.5), pajisje dhe makineritë (4.3), dhe barrierat ndërkufitare (4.3).

- **Plastika të tjera dhe\ose të përziera:** pajisje dhe makineritë (4.8), financat (4.3), barrierat ndërkufitare (.3).
- **Polietileni me densitet të ulët (PEDU):** korniza ligjore (3.0), taksat (3.0), dhe financat (2.5).
- **Polietileni me densitet të lartë (PEDL) :** taksat (4.0), financat (3.5), korniza ligjore (3.5) dhe barrierat ndërkufitare (3.5).
- **Polipropileni:** taksat (4.3), korniza ligjore (4.3), barrierat ndërkufitare (4.0).
- **Polietileni tereftalat (PET):** barrierat ndërkufitare (3.8), korniza ligjore (3.5), dhe taksat (3.5).
- **Polistireni:** korniza ligjore (4.0), taksat (4.0), dhe barrierat ndërkufitare (4.0).
- **Organike:** taksat (3.3), financat (3.0) dhe korniza ligjore (3.0).
- **Te tjera:** pajisje dhe makineritë (4.3), dhe financat (3.8).


Figura 16: Barrierat për rritje dhe zhvillim për nga lloji i mbetjes së blerë



Në ato kompani ku shitjet brenda vitit të kaluar ose shënuan rënie ose qëndruan njëjtë, disa paralele mund të tërhiqen bazuar në barrierat që penguan rritjen dhe zhvillimin e tyre. Pra, në të dyja rastet, dy barrierat më të shpeshta janë taksat dhe pajisjet dhe makineritë. Për të parën, gjetjet janë të plotësuara me gjetjet e tjera nga grupi i fokusit ku shumica e pronarëve\menaxherëve e ngritën

çështjen e taksës dhe akcizës së eksportit. Prandaj, qeveria duhet ta marrë në konsideratë dhe të dizajnojë politika të taksave të cilat do të rritnin konkurrueshmërinë dhe të lehtësonin eksportin.


Figura 17: Ndryshimet në shitje dhe barrierat



Barrierat u shtjelluan edhe më tej në bazë të madhësisë së kompanisë dhe moshës ose eksperiencës në atë fushë. Figurat më poshtë përfaqësojnë rezultatet nga ky këndvështrim. Bazuar në analizën e tabelave të kryqëzuara, model i ngjashëm mund të vërehet në rezultatin mesatar të barrierave në të dyja rastet. Domethënë, pajisje dhe makineritë, financat, dhe taksat janë tri barrierat të cilat mesatarisht kanë rezultat më të lartë bazuar në madhësinë dhe moshën e kompanisë.

Nëse analizohet në mënyrë më të detajuar, barrierat kryesore që kompanitë mesatare hasin janë financat (3.80), dhe taksat (3.70). Ndërsa, firmat mikro (3.61) dhe firmat e vogla (3.71) e konsiderojnë pajisjet dhe makineritë si barrierën kryesore. Siç pritej, ndërmarrjet e mesme konsiderohen të kenë kapacitete të brendshme më të mëdha dhe të janë më stabile, për këtë arsye, shqetësimi më i madh për ta janë financat për të përkrahur më tej planet e tyre të zhvillimit. Nga ana tjetër, për firmat mikro dhe ato të vogla, pajisje dhe makineritë janë kryesore, prandaj mungesa e këtyre burimeve e pengon funksionimin e tyre.


Figura 18: Barrierat sipas madhësisë së kompanisë



Për më tepër, pajisjet dhe makineritë shfaqen si barrierat kryesore edhe kur kontrollohet për moshën e kompanisë. Domethënë, firmat më të reja ose ato që kanë më pak se 5 vite (3.67) dhe ato që kanë 5-9 vite (3.90), e konsiderojnë pajisjet dhe makineritë si barrierë të tyre kryesore. Gjatë ciklit fillestar të biznesit të tyre, firmat më të reja hasin vështirësi në sigurimin e pajisjeve dhe makinerive të duhura, pra në mënyrë jo direkte kjo ndikon në funksionimin e tyre. Ndërsa për kompanitë që kanë 10-19 vite, taksat (3.71) tregojnë rezultatin më të lartë. Ndërsa ato firma që funksionojnë për më shumë se 20 vite, financat (3.50) dhe pajisjet dhe makineritë (3.59) janë barrierat më të mëdha që ata hasin.

Duke u mbështetur në argumentin e mësipërm për madhësinë, i njëjti arsyetim mund të jepet edhe në këtë rast. Pra, kompanitë më të mëdha dhe me më shumë vite veprimi i shohin financat dhe taksat e larta si barrierat të cilat e pengojnë zhvillimin e tyre. Ndërsa, sa i përket pajisjeve dhe makinerive, firmat me më shumë eksperiencë (20+ vite) mund të posedojnë pajisje të vjetërsuara dhe të amortizuara, si pasojë, ato nuk kanë kushte të duhura për të mbështetur shfrytëzimin e kapaciteteve të plota. Kjo nga ana tjetër mund të shpjegojë arsyen pse kapaciteti i prodhimit është kaq i ulët në mostrën e këtij studimi.

Figura 19: Barrierat e moshës së kompanisë



Shumicës së anketuarve ose 77% të tyre nuk u është dhënë asnjë mbështetje nga donatorë gjatë aktivitetit të tyre, duke treguar kështu nevojën për më shumë lobim për donatorë dhe programe ndërhyrëse të qeverisë në këtë sektor, e veçanërisht duke pasur parasysh potencialin për rritje, në kuptimin e rritjes së punësimit dhe eksportit.


Figura 20: Mbështetja nga donatorët



Rrjedhimisht, mbështetja e donatorëve është shtjelluar më tej bazuar në regjionin dhe madhësinë e kompanisë. Rezultatet vunë në pah se kompanitë të cilat kanë përfituar mbështetje nga donatorët, gjysma janë nga rajoni i Pejës dhe Ferizajt (secila nga 25%), e pasuar me kompanitë nga Prizreni (17%), Mitrovica (17%), Prishtina (8%), dhe Gjiçani (8%). Asnjë kompani e kësaj mostre nga Gjakova nuk ka pranuar ndonjë mbështetje


nga donatorë.

Figura 21: Mbështetja e donatorëve për rajon



Për më tepër, nëse kontrollojmë në bazë të madhësisë, rezulton që pjesa më e madhe e firmave që kanë pranuar mbështetje nga donatorët janë firmat e vogla (54%), pasuar nga ato mikro (23%) dhe ndërmarrjet e mesme (23%). Ky rezultat është intuitiv duke marrë parasysh shumë kufizime me të cilat këto kompani përballen. Ndërmarrjet e vogla kanë kapacitete të brendshme të limituara dhe janë në thelb të pa favorizuara në kuptimin e eksperiencës dhe madhësisë ose ‘’ përgjegjësisë së të qenurit i vogël’. Kjo nga ana tjetër shpjegon pse kompanitë e vogla krahasuar me kompanitë e mesme përkrahen nga donatorët në një shkallë më të madhe.


Figura 22: Mbështetja e donatorëve dhe madhësia e kompanisë



8. Gjetjet për ekonominë qarkore

Inovacioni në modelin e biznesit të gjelbër ndodhë atëherë kur ‘ një biznes ndryshon pjesë të modelit të biznesit të tij dhe kështu merr edhe vlerat ekonomike si dhe zvogëlon gjurmët ekologjike negative në të ardhmen e ciklit jetësor (Bisgaard & Henriksen, 2012). Duke marrë parasysh rëndësinë së saj, shumë biznese nuk kanë njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore ose zbatimin e standardeve të cilësisë së mbrojtjes së mjedisit. Të dhënat e anketës tregojnë se më pak se dy e treta e kompanive zbatojnë standardet e cilësisë për të siguruar mbrojtje të ambientit. Për ato kompani të cilat posedojnë standarde të cilësisë, Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ONS) është lloji dominues (70%), pasuar nga certifikimi i Konformitetit Evropian (KE) (20%), dhe Çertifikimi Ndërkombëtar i Qëndrueshmërisë dhe Karbonit (ÇNQK) (10%).

Figura 23: Aplikimi i standardeve të kualitetit për mbrojtje të mjedisit




Pjesa më e madhe e mostrës (64%) nuk kanë njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore, ndërsa 36 % e njohin këtë koncept.

Figura 24: Shkalla e njohjes së konceptit të ekonomisë qarkore




Në mënyrë shqetësuese, gati shumica e të anketuarve (46%) e konsiderojnë mesatarisht të rëndësishëm zbatimin e praktikave të ekonomisë qarkore në zvogëlimin e përdorimit të lëndës së parë, energjisë dhe ujit. Pjesa e mbetur e konsiderojnë si më pak të rëndësishme (7%), dhe aspak të rëndësishme (19%). Ndërsa, vetëm 22% dhe 7% konsiderojnë zbatimin e praktikave kryesore të ekonomisë si shumë të rëndësishme dhe përkatësisht jashtëzakonisht të rëndësishme. Këto gjetje, tregojnë nevojën që palët kryesore të interesit sikurse që janë agjencitë e qeverisë, donatorët dhe shoqatat e biznesit, të ndërmarrin masa që do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e tranzicionit drejt një ekonomie qarkore, çfarë nënkupton dhe çfarë duhet të bëjnë kompanitë për të ripërshtatur modelet e tyre të biznesit në mënyrë që të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe të rrisin qarkullimin e materialeve.

Figura 25: Rëndësia e praktikave të ekonomisë qarkore në mbrojtjen e mjedisit



Ata të cilët nuk e njohin konceptin e ekonomisë qarkore, e vlerësojnë zbatimin e praktikave të ekonomisë qarkore në zvogëlimin e lëndës së parë, energjisë dhe ujit si aspak të rëndësishme (10) ose mesatarisht të rëndësishme (18). Ndërsa, ata të cilët e njohin shumë mirë konceptin e ekonomisë qarkore, 9 e konsiderojnë rolin e ekonomisë qarkore si mesatarisht të rëndësishëm, 6 shumë të rëndësishëm, dhe 4 jashtëzakonisht të rëndësishëm.


Figura 26: Shkalla e njohjes së ekonomisë qarkore dhe rëndësia e saj



Rezultatet tregojnë që njohja me ekonominë qarkore lidhet me vlerësimin e të anketuarve për rëndësinë e zbatimit të praktikave të ekonomisë qarkore në mbrojtjen e mjedisit. Domethënë, ata të cilët nuk e njohin konceptin e ekonomisë qarkore, e vlerësojnë zbatimin e praktikave të ekonomisë qarkore si aspak të rëndësishme dhe mesatarisht të rëndësishme. Me fjalë të tjera, mungesa e vetëdijesimit për vetë ekonominë qarkore përkthehet si interesim i ulët drejt praktikave të ekonomisë qarkore. Për këtë arsye, kjo ngritë nevojën për edukim jo-formal dhe programe trajnimi të dedikuara për komunitetin e biznesit të mbetjeve dhe riciklimit në Kosovë. Këto të dhëna plotësohen me të dhëna të studimeve të cilat kanë raportuar mungesë të përgjithshme të vetëdijesimit për terminologjinë e ekonomisë qarkore. Nevojiten përpjekje dhe masa të rëndësishme për të rritur mundësitë e trajnimit dhe të të mësuarit për kompanitë private dhe ato publike në mënyrë që të kuptojnë ekonominë qarkore dhe përfitimet që rrjedhin nga zbatimi i saj. Shoqatat e biznesit që operojnë në këtë sektor dhe kompani të industrive të ndryshme mund të konsiderojë ofrimin e moduleve të trajnimit për ekonominë qarkore për anëtarët e tyre.

Krejt në fund, shkalla e njohjes me ekonominë qarkore është analizuar në relacion me aktivitetin ose fazën ricikluese të zinxhirit të vlerës. Rezultatet tregojnë që kompanitë në fazën e klasifikimit, përkatësisht, ato që kanë të bëjnë me ndarje në burim (74%) dhe ato me makineri të veçanta të linjës së ndarjes së mbetjeve të përziera (71%), e njohin më mirë konceptin e ekonomisë qarkore.

Figura 27: Shkalla e njohjes së ekonomisë qarkore nga aktiviteti



9. Rezultatet e gjetjeve të shoqatës së riciklimit

Rezultatet e fazës së kërkimit dhe diskutimet në fokus grup me kompanitë e sektorit privat treguan pozitivisht nevojën që kompanitë që operojnë në zinxhirin e vlerës së riciklimit të organizojnë dhe krijojnë një platformë që do të identifikojë barrierat, të shprehë shqetësimet dhe të mbështesë zhvillimin e sektorit të riciklimit. Në kuadër të OEK-ut, ekziston një shoqatë për riciklimin e themeluar në vitin 2007, por për arsye të ndryshme, shoqata nuk ka qenë aktive në katër vitet e fundit. Ky aspekt u trajtua gjatë fazës së anketimit.


Shumica e të anketuarve (87%) shprehin vullnetin e tyre për tu anëtarësuar në Shoqatën e Riciklimit nën ombrellën e OEK.

Figura 28: Gatishmëria për t'u anëtarësuar në Shoqatën e Kompanive të Riciklimit



Bazuar në rezultatet, firmat kanë pritshmëri që OEK ti mbështesë kryesisht me lobim dhe përkrahje, duke vazhduar me ngjarje rrjetëzimi, trajnime, shërbime të know-how/konsulencës, dhe të tjera.

Figura 29: Llojet e mbështetjes që priten nga Oda Ekonomike e Kosovës (në përqindje)



Siç mund të vijnë në përfundim, komuniteti i biznesit konsideron që nevojat e tyre kanë qenë të lëna pas dore për një kohë të gjatë. Prandaj, Shoqata e Riciklimit e cila pritet të funksionojë nën ombrellën e OEK, duhet të dëgjojë në mënyrë aktive problemet e tyre, të mbrojë çështjet që ata kanë, dhe të adresojë nevojat e tyre menjëherë. Gjithashtu, organizimi i ngjarjeve të rrjetëzimit dhe i trajnimeve do të ishte i dobishëm në rritjen e kapaciteteve të të bërit biznes, shkëmbimin e praktikave më të mira të tyre, si dhe promovimin e eksportit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe mbështetja e OEK në aspektin e know-how. Kjo plotësohet me një gjetje tjetër e cila ka të bëjë me investimet, që tregon se kompanitë nuk kishin investuar në know-how në tre vitet e fundit, megjithatë, ata planifikojnë të investojnë në këtë drejtim në tre vitet e ardhshme. Në këtë kontekst, OEK mund të konsiderojë ofrimin e shërbimeve të konsulencës së know-how për ato kompani me të cilat ndërlidhen angazhimet e tyre afatgjata drejtpërdrejtë.

Për më tepër, bashkëpunimi me shoqatat e tjera duhet të forcohet për të siguruar përafrimin e sinergjive dhe për të mbështetur zhvillimin e sektorit të riciklimit.

10. Gjetjet e grupit të fokusit

Në këtë pjesë raportohen gjetjet nga grupi i fokusit të pronarëve/menaxherëve të kompanive private që operojnë në zinxhirin e vlerës të sektorit të riciklimit. Grupet e fokusit zakonisht

zhvillohen me grupe homogjene pjesëmarrësish për të lehtësuar diskutimin dhe për të pasur njohuri më të thella të fenomenit (Salgado, 2011). Për të trajtuar grupin e madh të shpërndarjes rajonale të kompanive në sektorin e riciklimit, si dhe llojet e fraksioneve të mbetjeve me të cilat merren, ne kemi ftuar në fokus grup kompani që operojnë me materiale të ndryshme si plastika, metalet, letra etj.

Për të diskutuar çështjet e potencialit për zhvillim dhe barrierat për rritje të sektorit të riciklimit si dhe ndërgjegjësimin dhe nivelin aktual të informacionit në lidhje me ekonominë qarkore, OEK së bashku me institutin IESB kanë formuar diskutime në grupe fokusi me mostër të 11 menaxherëve/pronarët. Pjesëmarrësit në këtë grup fokusi ishin pronar të bizneseve të ndryshme të cilët në mënyrë adekuate përfaqësojnë panelin e kategorive të të gjithë aktiviteteve të zinxhirit të vlerës sikurse grumbullimi, përpunimi, shitjet dhe eksportimi. Ekipi i IESB-së ka bërë përpjekje për të pasur mbulim më të gjerë rajonal në Kosovë. Kjo është e rëndësishme sepse jo të gjitha kompanitë në riciklim janë pjesë e aktiviteteve të zinxhirit të vlerës që nga grumbullimi e deri tek produkti final, që vë në dukje rëndësinë e metodologjisë së mostrës së qëllimshme në grupin e fokusit.

Ne përdorëm *teknikën e mostrës së qëllimshme* për të identifikuar firmat të cilat bëjnë pjesë në të gjitha proceset e zinxhirit të vlerës ose që të paktën të sigurojnë shpërndarjen e mjaftueshme të firmave në çdo zinxhir të vlerës në riciklim. Në përputhje me këtë qëllim ne kemi krijuar udhëzime për grupe fokusi, kemi identifikuar disa çështje/tema diskutimi për të vendosur nivel zhvillimi për këtë sektor, barrierat dhe nevojat e kompanive ricikluese, potencialin për eksport dhe punësim dhe gjithashtu vetëdijësimin për ekonominë qarkore. Eksperti kryesues Besnik Krasniqi ishte ndërmjetës i grupit të fokusit, ndërsa stafi tjetër mbështetës nga Instituti IESB asistonin duke marrë shënime dhe punonin në nxjerrjen e përfundimeve më të rëndësishme të marra nga grupi i fokusit. Grupi i fokusit filloi diskutimet e pjesëmarrësve në pesë fusha të shërbimeve publike dhe biseduan për kënaqësitë që konsumatorët kishin në lidhje me ato shërbime. Tabela 6 tregon rezultatet kryesore të grupit të fokusit.

Tabela 6: Përmbledhje e rezultateve na grupi i fokusit dhe implikimet e politikave

	<i>Citatet kryesore të zgjedhura</i>	<i>Gjetjet kryesore</i>	<i>Nënkuptimet për qeverinë, organizatat e donatorëve, shoqëritë e bizneseve</i>
--	--------------------------------------	-------------------------	--

<p>Gjendja aktuale e sektorit të riciklimit dhe potenciali për rritje</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>“Kompania jonë merret me riciklim të plastikës. Produkti final është fleta metalike me bazë plastike e cila përdoret ne sektorin e agrikuturës, në ndërtim, dhe në ambalazhim. Kompanitë të cilat eksportojnë në më shumë se 18 vende nëpër botë”.</i> • <i>” ...kompania jonë bën prodhimin e qeseve të plastikës/qeseve të mbeturinave(rigranulim)</i> • <i>Euro steel Mushi grumbullon materiale të riciklueshme, i klasifikon ato, dhe pastaj i eksporton</i> • <i>” Kompania ime grumbullon, klasifikon dhe eksporton metale, bakër, alumin, dhe zink, pra në përgjithësi metale, procesi vazhdon kështu deri në fazën e dorëzimit në shkretore”</i> • <i>”... ne riciklojmë metale (qelik të copëtuar) dhe goma,, është i vetmi i këtij lloji në Kosovë. Fokusi është në riciklimin e materiale dytësore në mbeturina”.</i> • <i>“Ne kemi portencial për rritje, por kemi nevojë për më shumë investime në makineri dhe pajisje, gjë që është e kushtueshme”.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • Potencial i lartë për rritje dhe eksport • Disa kompani janë pjesë e zinxhirit të plotë të vlerës në riciklim dhe e komplet ciklit të riciklimit nga grumbullimi i mbetjeve e deri tek produkti final • Potencial për zgjerim të mëtejshëm të produkteve bazuar në riciklimin e mbetjeve • Kompanitë të cilat nuk prodhojnë produkte finale për përdoruesit fundor janë të gatshëm për të kaluar në fazën e zhvillimit, por kanë nevojë për investime kapitale dhe përkrahje financiare 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i ekosistemit për të përkrahur kompanitë e riciklimit që të kapin mundësitë e tregut të cilat qojnë në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e eksportit, • Skemat e granteve konkretisht për këtë sektor, janë të nevojshme për rritje të investimeve, punësim dhe eksport dhe si rrjedhim të rrisin grumbullimin e mbetjeve dhe riciklimin
<p>Barrierat që pengojnë zhvillimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Autoritetet qeveritare dhe komunat duhet të bëjnë më shumë për të bërë grumbullimin dhe klasifikimin e mbetjeve. Ne më shumë varem nga mbledhësit jo formal të mbetjeve, gjë që limiton kapacitetet tona..</i> • <i>“Një nga problemet shqetësuese për kompaninë është akciza që Shqipëria ka</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • Vetëdijësimi dhe kultura e përgjithshme e riciklimit parashtron një pengesë në klasifikim dhe grumbullim • Mungesa e klasifikimit të mbetjeve nga shërbimet publike dhe autoritetet e tjera përgjegjëse 	<p>Promovimi i kulturës së riciklimit duhet të fillojë nga zona e vogla/rurale pasi vendbanimet rurale kanë shtëpi banimi dhe do të ishte më e lehtë të ngrihet një sistem për të zbuluar njerëzit të cilët nuk ndajnë mbetjet dhe të ndëshkohen për moszbatim të rregullave.</p>

	<p><i>me Kosovën dhe e bën të pamundur për ne të jemi konkurrues në tregun shqipëtar“</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>.... Problemi më i madh që ka kompania është furnizimi me lëndë të parë. Ne tani riciklojmë 900kg/h por së shpejti pritet që të rinovojmë kapacitetet duke tejkalluar 1600kg/h e cila do të rezultojë me 8 milion kilogram riciklim në vit. Maqedonia, Mali i Zi dhe Greqia janë vendet nga të cilat ne furnizohemi me lëndë të parë. Tani si kompani, ata importojnë rreth 30-40% nga jashtë“</i> "Plastika" • <i>“Edhe pse shteti nuk na përkrahë ose stimulon me subvencione, ne jemi konkurrues në treg”</i> • <i>“TVSH-ja në mbetje është shumë problematike për ne, Bashkimi Evropian nuk i ka këto lloje të praktikave”</i> • <i>Kosova kërkon leje të veçanta për transportimin e mallrave. Për secilën kompani me të cilën kemi bashkëpunim, duhet marrë leje të veçantë dhe procedurat në ministri janë të zgjatura, kjo në mënyrë jo direkte ndikon në bashkëpunimin me kompani ndërkombëtare.</i> • <i>Procedurat për leje të eksportit dhe importit janë të gjata</i> • <i>Kosova nuk është pjesë e Konventës së Bazelit dhe e</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • Akcizat me Shqipërinë dhe vendet e tjera parashtron një pengesë në zhvillim • Qasja në deponinë e qytetit nuk lejohet për arsye sigurimi, por duhet të shqyrtohet më tej se si mund të lejohet • Mungesa e mbështetjes së qeverisë në sektorin e riciklimit • Konventa e Bazelit e limiton eksportin e mbetjeve dhe mbeturinave 	<p>Nevojë për të rishqyrtuar nxitjen fiskale për sektorin e riciklimit</p> <p>Qeveria duhet të bëjë përpjekje për anëtarësimin e Kosovës në Konventën e Bazelit</p> <p>Marrëveshjet bilaterale mund të përdoren si zgjidhje për të lehtësuar eksportin dhe për të shmangur këto barrierë. Ministria e Punëve të Jashtme duhet të llojë në këtë aspekt</p> <p>OEK dhe shoqatat e tjera të biznesit duhet të lehtësojnë dhe përkrahin ndryshimin në këtë sektor</p>
--	---	--	---

	<i>bën të pamundur ekportimin e "mbeturinave" direkt në BE, por parimet e Konventës së Bazelit zbatohen në Kosovë. Kompanitë nga Kosova eksportojnë "mbeturina" në mënyrë jo direkte nga vendet e regjionit.</i>		
--	--	--	--

Në çështje e cila është venë në pah nga pothuajse të gjithë pjesëmarrësit gjatë diskutimit ishte mbështetja joadekuate ose mungesa e përkrahjes së kompanive në sektorin e riciklimit. Shqetësimet e kompanive të riciklimit vijnë nga iniciativat fiskale joadekuate, mungesa klasifikimit të mbetjeve dhe procedurat e zgjatura burokratike e deri tek mungesa e përkrahjes nga donatorët me grante për këtë sektor. Siç potencohet nga pjesëmarrësi i grupit të fokusit “Politikat e rimbursimit të TVSH-së janë të ndërlikuara dhe i dekurajojnë kompanitë që të kërkojnë rimbursime gjë që neve na shkakton humbje”. Bazuar në gjetjet nga grupi i fokusit, ATK ka vendosur një vlerë prej 3% në grumbullimin e mbetjeve, kjo shënoj një rënie për 1% këtë vit, por sipas pjesëmarrësve kjo taksë nuk duhet të ekzistojë fare. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit konfirmuan që si blerës të materialeve të mbetjeve i mbajnë 1 % të taksave për të gjithë personat fizik që i furnizojnë ata me mbetje. Megjithatë, bazuar në ligjin e tanishëm të tatimeve, kompanitë me përgjegjësi të kufizuar (personat juridik) paguajnë vetëm 1 % ndërsa bizneset individuale (personat fizik) paguajnë 3% pagesë bruto. Kjo ndodhë sepse Ligji i Tatimor mbi Korporatat është miratuar ndërsa projektligji për tatimin mbi të ardhurat personale me amendamentet e saj ende nuk është miratuar nga Kuvendi. Të dyja ligjet e vendosin vlerën 1 % për të gjithë personat fizik dhe jo për biznesmen, megjithatë, bizneset individuale duhet të paguajnë 3 % derisa të aprovohet Ligji për Tatime për të Ardhura Personale nga Parlamenti.¹ Kjo ka vënë në pozitë jo të favorshme bizneset individuale krahasuar me korporatat për sa i përket blerjes së mbetjeve nga grumbullues individual joformal dhe kanë nevojë të jenë në harmonizim. Thënë ndryshe, për autoritetet tatimore është më e lehtë të mbledhin taksat nga bizneset që blejnë mbetje nga personat fizik sesa nga personat fizik që iu shesin këtyre bizneseve.

¹ See Law No. 05/L -028 On Personal Income Tax and Administrative Instruction No.01/2016 Implementing The Law No.05/L-028 On Personal Income Tax

Kompanitë gjithashtu duhet të paguajnë 25 € për kamion kur bëjnë eksportimin e radioaktivitetit dhe disa kompani eksportojnë 100%. Këto të dhëna nga grupi i fokusit mbështeten gjithashtu nga të dhënat e anketimit që tregojnë se stimujt fiskal kanë rëndësi në zhvillimin e këtij sektori. Rishqyrtimi i këtyre stimujve fiskal duhet të jetë prioritet i qeverisë.

Tregtia ndërkufitare e mbetjeve ose produkteve me bazë mbetje paraqet një tjetër barrierë për zhvillimin e këtij sektori. Siç theksohet në grupin e fokusit:

“Shqipëria nuk na e lejon transportimin e lëndës së parë; kjo shkakton probleme për kompanitë. Shteti ka nevojë të gjejë ndonjë formë të subvencionimit të eksportit për të na mundësuar që të jemi më konkurrues në treg. Serbia zbaton mbështetjen e eksportit, dhe kjo fuqizon kompanitë e Serbisë që të jenë më konkurruese në tregje ndërkombëtare”

Qeveria duhet të rikonsideroj disa aspekte të taksave në mënyrë që të promovojë grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe aktivitetet ricikluese. Stimuj të tjerë jo fizik mund të përfshijnë grante për përmirësimin e teknologjisë, skema të zhvillimit të fuqisë punëtore, skemat e trajnimeve dhe voucher-ve për ekonominë qarkore dhe forma të tjera të eksportit të subvencionuar.

11. Përfundimet, nënkuptimet dhe rekomandimet për politika

Studimi ofron një numër implikimesh për politika si dhe rekomandime për qeverinë, komunat, organizatat donatore, OEK, shoqatat e bizneseve dhe kompanitë e riciklimt duke formuar bazën për përcaktimin e politikave që zhvillojnë tutje sektorin e riciklimit në Kosovë. Duke u mbështetur në evidencën cilësore (diskutim në grupe fokusi) dhe atë sasiore (pyetësori me kompanitë e riciklimit), studimi ofron përfundimet e mëposhtme dhe rekomandimet përkatëse për të nxitur investime dhe për të zhvilluar sektorin e riciklimit:

- Performanca e kompanive në zinxhirin e vlerës së riciklimit është premtuese dhe me ambicie të larta për të bërë investime shtesë dhe për t'u zhvilluar më tutje, kjo deklaratë mbështetet nga gjetjet, cilësore dhe ato sasiore. Në tre vitet e kaluara sektori u rrit në mesatare gati 10 % dhe do të dyfishohet në tre vitet e ardhshme. Megjithatë, sektori i riciklimit përballet me disa barrierë që lidhen me taksat, strukturën institucionale, financimin, dhe qasjen në fuqinë punëtore të kualifikuar.

- Barrierat që kompanitë hasin për tu rritur dhe zgjeruar janë analizuar në lidhje me **fazën e aktivitetit të zinxhirit të vlerës** që janë të përfshirë. Nëse flasim në përgjithësi, barrierat ndërkufitare dhe taksat janë barrierat që hasen më së shpeshti nga kompanitë. Varësisht fazës së zinxhirit të vlerës që janë të përfshirë, barrierat kryesore për kompanitë e grumbullimit dhe shitjes janë barrierat ndërkufitare (doganat), ndërsa për kompanitë e klasifikimit dhe përpunimit janë taksat.
- Barrierat janë analizuar në lidhje me **llojin e mbetjeve** që blejnë kompanitë. Barrierat kryesore për kompanitë që blejnë mbetje letre dhe qelqi janë barrierat ndërkufitare, për kompanitë që blejnë mbetje plastike dhe organike janë taksat, për kompanitë që blejnë mbetje metali janë financat, dhe për kompanitë që blejnë mbetje të tjera barrierat kryesore janë pajisje dhe makineritë.
- Gjetjet e hulumtimit tregojnë që ato kompani në të cilat shitjet brenda vitit të kaluar ose patën rënie ose qëndruan njëjtë, si barriera kryesore i shohin taksat si dhe pajisjet dhe makineritë. Gjetjet nga grupi i fokusit gjithashtu theksojnë që taksat dhe akciza janë barriera për eksportin.
- Duke bërë një analizë më të thellë të barrierave me fokus në madhësinë dhe moshën e kompanisë, në të dyja rastet mesatarja e numrit të përgjithshëm të barrierave tregon një model të ngjashëm të cilin pajisjet dhe makineritë, financat dhe taksat treguan rezultate më të larta. Një aspekt thelbësor është nevoja e këtij sektori për investime në pajisje dhe makineri. Bazuar në gjetjet e studimit, firmat e madhësive dhe eksperiencës së ndryshme në këtë fushë shprehën nevojën dhe qëllimet për investime në pajisje dhe makineri në të ardhmen e afërt.
 - **Madhësia:** Barriera kryesore që hasin kompanitë e madhësisë së mesme janë mungesa e financave dhe taksat që po pengojnë zhvillimin e tyre. Ndërsa, firmat e vogla dhe ato mikro i konsiderojnë pajisjet dhe makineritë si barrierën kryesore, për shkak se varen shumë nga këto burime.
 - **Mosha:** Firmat më të reja ose ato që kanë më pak se 5 vite dhe ato me 5-9 vite e konsiderojnë pajisjet dhe makineritë si barrierë të tyre kryesore. Gjatë fazës

fillestare të biznesit të tyre, firmat më të reja hasin vështirësi në sigurimin e pajisjeve dhe makinerive të duhura, për këtë arsye funksionimi i tyre ndikohet direkt nga kjo. Ndërsa, kompanitë që kanë 10-19 vite, taksat tregojnë rezultate më të larta, në anën tjetër firmat që kanë 20+ vite veprimi, financat, pajisje dhe makineritë janë barrierat kryesore që ata hasin. Duke u mbështetur në argumentet e mëhershme për madhësinë, i njëjti arsyetim mund të përdoret edhe në këtë rast. Domethënë, firmat më të vjetra dhe më të mëdha i shohin taksat e larta dhe financat si barriera që e pengojnë zhvillimin e tyre. Ndërsa, për sa i përket pajisjeve dhe makinerive, firmat me më shumë eksperiencë (20+ vite) mund të posedojnë pajisje të vjetra dhe të amortizuara, prandaj nuk janë në gjendje të duhur për të mbështetur përdorimin e kapaciteteve të plota. Kjo nga ana e saj mund të shpjegojë arsyen pse kapaciteti i prodhimit është kaq i ulët në mostrën e këtij studimi.

- Barrierat kryesore të identifikuara nga kompanitë e riciklimit janë çështjet fiskale, qasja në fuqi punëtore dhe procedurat e tjera burokratike.
 - Fillimisht, menaxhimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve në Kosovë nga autoritetet publike nuk është duke funksionuar mirë, mungon infrastruktura për grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe klasifikimi i mbetjeve në deponi është i kufizuar. Prandaj kompanitë varen më shumë nga mbledhësit jo formal gjë që i limiton kapacitetet e grumbullimit të mbetjeve dhe si rrjedhojë ka pasoja negative për të gjithë procesin e zinxhirit të vlerës, duke limituar gjithashtu potencialin për rritje dhe eksportim. Infrastruktura e përgjithshme, ndërgjegjësimi dhe kultura e riciklimit paraqet pengesë shtesë në klasifikim dhe grumbullim të mbetjeve. Institucionet duhet të investojnë në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim, grumbullimin dhe trajtimin e duhur, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zbatimin e legjislacionit.
 - Akciza me Shqipërinë dhe vendet e tjera parashtron një pengesë në zhvillimin dhe eksportin e këtij sektori. Shqipëria nuk e lejon transportimin e lëndës së parë nga Kosova, kjo shkakton probleme për kompanitë. Qeveria e Kosovës duke përfshirë

edhe rolin aktiv të OEK duhet të gjejnë ndonjë formë të subvencionimit të eksportit për të mundësuar që kompanitë të jenë më konkurruese në treg.

- TVSH-ja në grumbullimin e mbetjeve është një pengesë për rritje, dhe përveç kësaj nuk është në përputhje me praktikën e BE-së prandaj duhet marrë në konsideratë nga qeveria e Kosovës. Gjithashtu, studimi sugjeron që praktikën e rimbursimit të TVSH-së janë të ndërlikuara dhe i dekurajojnë kompanitë që të kërkojnë rimbursim, gjë që shkakton humbje dhe dekurajon investimet në këtë sektor.
- Ulja e taksës së qarkullimit në grumbullimin e mbetjeve nga 3% në 1% ka ndikuar pozitivisht në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme mirëpo është urgjente që Parlamenti i Kosovës të harmonizoj Ligjin për Tatimin në të Ardhura Personale me Ligjin për të Ardhura të Korporatave në mënyrë që të lejohet që bizneset individuale të paguajnë 1 % në vend të pagesës bruto 3 % nga grumbulluesit joformal të mbetjeve. Përveç kësaj, qeveria duhet të konsiderojë stimuj fizik dhe jo fiskal (p.sh, grante për përmirësimin e teknologjisë, për kompanitë e riciklimit të mbetjeve) për të promovuar grumbullimin e mbetjeve. Shfaqja e këtyre stimujve fiskal ka rëndësi për zhvillimin e këtij sektori. Rikonsiderimi i këtyre stimujve fiskal për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme duhet të jetë prioritet për qeverinë.
- Qasja në fuqi punëtore të aftë e sidomos për kompanitë me shkallë më të lartë të cilat kanë nevojë të operojnë me pajisje dhe makineri përfaqësojnë barrierë për ta. Një rekomandim i menjëhershëm për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është lobimi dhe bërja e OEK-ut partner për zhvillimin e strategjisë arsimore të vendit, e cila nga ana tjetër do të trajtonte hendekun në tregun e punës. Ndërsa, në plan afatgjatë, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet zhvillimit të programeve specifike për nevojat e sektorit të riciklimit në formën e programeve mbështetëse sikurse trajnimet dhe zhvillimi i fuqisë punëtore.
- Qeveria dhe organizatat e tjera të biznesit sikurse OEK duhet të marrin rol drejtues në lobim për zgjidhjen e çështjeve ndërkufitare dhe të konsiderojnë prezantimin e stimujve për eksport për këtë sektor. Për më tepër, kjo ngre një çështje shumë me

rëndësi për kompanitë ricikluese duke sugjeruar nevojën për rivitalizimin e një shoqate për kompanitë ricikluese në kuadër të OEK. Kjo shoqatë duhet të ketë një rol aktiv në lobim dhe përkrahje të politikave miqësore për sektorin e riciklimit. Duhet të forcohet bashkëpunimi me shoqatat e tjera që operojnë në këtë sektor.

- Për shkak se Kosova nuk është pjesë e Konventës së Bazelit², për kompanitë e riciklimit është e pamundur të eksportojnë skrap direkt në BE, edhe pse parimet e Konventës së Bazelit zbatohen në Kosovë. Për më tepër, rezultatet e anketës zbuluan se ekziston një mungesë specializimi ndër firma e cila pjesërisht do ti atribuohet madhësisë së vogël të tregut të brendshëm. Për këtë arsye, eksporti mund të shihet si mundësi atraktive për tu futur në tregje më të mëdha të cilat e lejojnë specializimin. Si pasojë, kompanitë nga Kosova eksportojnë skrap në mënyrë indirekte nga vendet e rajonit, duke bërë që kompanitë nga Kosova të jenë të jo-konkurruese për shkak të kostos së lartë të grumbullimit dhe shitjes. Kompanitë kosovare duhet të përdorin kontraktorë të shërbimeve të transportit nga rajoni, pasi automjetet e regjistruara në Kosovë nuk mund të eksportojnë në BE. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje të konsiderueshme për anëtarësim në Konventën e Bazelit në mënyrë që të nxisin rritjen e eksportit në sektorin e riciklimit.
- Përveç kësaj, përdorimi i marrëveshjeve bilaterale të Kosovës me vende të tjera mund të jetë zgjidhje për lehtësimin e eksportit dhe veçanërisht të shmang barrierat administrative. Në këtë aspekt duhet të llobojë Ministria e Punëve të Jashtme, OEK, si dhe shoqatat e tjera të biznesit të cilat mund ta lehtësojnë dhe përkrahin ndryshimin në këtë sektor.
- Në lidhje me financimin e kompanive, gjetjet sugjerojnë që ka mungesë të mbështetjes nga qeveria për kompanitë që operojnë në zinxhirin e vlerës së riciklimit prandaj është i nevojshëm hartimimi i skemave të financimit për mbështetjen e investimeve kapitale në këtë sektor. Investimet kapitale të nevojshme

² The Basel Convention On The Control Of Transboundary Movements Of Hazardous Wastes And Their Disposal <https://www.basel.int/Portals/4/Basel%20convention/Docs/Text/Baselconventiontext-E.Pdf>

për teknologjinë moderne në makineri dhe pajisje janë shumë të larta. Qeveria dhe donatorët duhet të punojnë së bashku në mënyrë që të shpalosin një skemë të veçantë granti ose financimi për të mbështetur kompanitë e riciklimit. Përndryshe, ata duhet të prezantojnë një nënkomponent të sektorit të riciklimit në planet e tjera të granteve për sektorin privat.

- Kompanitë presin mbështetje nga OEK në lidhje me lobimin dhe avokimin, ngjarjet e rrjetëzimit, trajnimin, dhe shërbimet know-how/ konsulencës. Prandaj, duhet të themelohet Shoqata e Riciklimit e cila në mënyrë aktive dëgjon problemet e tyre, mbron çështjet e tyre, dhe menjëherë i adreson nevojat që ata kanë. Përveç kësaj, organizimi i ngjarjeve të rrjetëzimit dhe trajnimet do të ishin të dobishme për të rritur kapacitetet e tyre për të bërë biznes, për të shkëmbyer praktikat më të mira të tyre, si dhe për promovimin e eksportit.
- Një tjetër aspekt me rëndësi është përkrahja e OEK me know-how. Gjetjet tregojnë se kompanitë planifikojnë të investojnë në këtë drejtim në tre vitet e ardhshme. Në këtë kontekst, OEK mund të konsiderojë t'iu ofrojë konsulencë të shërbimeve dhe know-how e cila ndërlihet direkt me angazhimet e tyre afatgjata. Një qasje e ngjashme mund të zbatohet edhe nga shoqata të tjera që mbështesin zhvillimin e sektorit dhe bashkëpunojnë drejtpërdrejt me kompanitë.
- Rezultatet tregojnë që ata që nuk e njohin konceptin e ekonomisë qarkore, i vlerësojnë praktikat e implementimit të ekonomisë qarkore si jo edhe aq të rëndësishme ose mesatarisht të rëndësishme. Në fakt, dy të tretat e bizneseve nuk e njohin konceptin e ekonomisë qarkore. Me fjalë të tjera, mungesa e ndërgjegjësimit për vetë ekonominë qarkore tregon konsideratë të ulët ndaj mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, kjo shfaq nevojën për edukim jo formal dhe programe trajnimi për komunitetin e bizneseve të mbetjeve dhe të riciklimit në Kosovë. OEK mund të marrë parasysh ofrimin e moduleve të trajnimit në ekonominë qarkore për anëtarët e ardhshëm së saj. Për adresimin e kësaj çështje, qeveria, donatorët, shoqatat dhe palët e tjera të interesit duhet të punojnë bashkërisht në:

- Krijimin e një Qendre/Hub-i për Ekonomi Qarkore përbrenda OEK-ut për të mbështetur kompanitë anëtare në përshtatjen dhe zbatimin e modeleve të biznesit të ekonomisë qarkore në ciklin e tyre të prodhimit dhe operacionet e përditshme, përmes programeve të trajnimit, mbështetjes teknike, ngjarjeve të rrjetëzimit etj. Kjo mbështetje duhet të shtrihet për të gjitha kompanitë që operojnë në industri të ndryshme.
- Propozimin e një program trajnimi për sipërmarrjen e gjelbër dhe ekonomin qarkore dhe seminare për bizneset për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet e përdorimit të teknologjive të gjelbra për të ulur kostot dhe për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë dhe ekonomi qarkore në përgjithësi. Punëtoritë dhe sesionet informuese me grupe lokale dhe biznese private, të cilat bazohen në praktikën e BE-së, mund të jenë një nga mënyrat për të rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje.
- Zhvillimin fushatave edukative dhe informuese për të edukuar publikun mbi përfitimet e ndarjes së mbetjeve, praktikën e riciklimit, objektet lokale të riciklimit dhe mënyrën se si ato kontribuojnë në sistem. Në mënyrë të ngjashme, avokimi me komunitatet dhe institucionet e tjera për të siguruar infrastrukturën parësore për ndarjen e mbeturinave në mënyrë që të rritet cilësia dhe sasia e materialeve të riciklueshme.
- Bashkëpunimin me shkollat lokale për të zhvilluar materiale edukative që nxisin studentët të ndjekin karriera të gjelbra, të cilat potencialisht mund të kontribuojnë në ndërtimin e ekspertizës teknike lokale për të ardhmen e riciklimit.

12. Referencat

Alkhateeb, T., Muñoz, M. R., Rohmah, G. A., Tang, H., & Walter, A. M. (2017). Economic Impacts of the Dardania Waste Bank Project. In U. Kienast-Duyar, N. Korf, & O. Larsen (Eds.), *Solid Waste Management in Kosovo: Assessment of a Waste Bank Model in Dardania, Pristina*. Berlin: Urban Management Program - Berlin University of Technology. Retrieved from https://www.urbanmanagement.tu-berlin.de/fileadmin/f6_urbanmanagement/News/HP_Online_Kosovo_Report_6.pdf

- Andreas von Schoenberg Consulting. (2021, February 20). *von Schoenberg projects*. Retrieved from von Schoenberg info: <https://vonschoenberg.info/en/projects/>
- ASK. (2021). *Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2020*. ASK - Kosovo Statistics Agency. Retrieved from <https://ask.rks-gov.net/media/6382/anketa-e-mbeturinave-t%C3%AB-trajtuara-2020-shqip.pdf>
- Balkan Forum. (2021). *Circular Economy in the Western Balkans region*. Balkan Forum. Retrieved from https://thebalkanforum.org/file/repository/Circular_Economy_in_the_Western_Balkans_region.pdf
- Bisgaard, T., & Henriksen, K. B. (2012). *Green Business Model Innovation-Conceptualisation*. Oslo, Norway: Next Practice and Policy.
- Calma, J. (2020). *Aluminum is recycling's new best friend, but it's complicated*. The Verge. Retrieved from <https://www.theverge.com/2019/9/12/20862775/aluminum-recycling-water-tech-plastic-manufacturing-cocacola-pepsi-apple>
- Circle Economy. (2022). *The Circularity Gap Report 2022*. Amsterdam: Circle Economy. Retrieved from https://drive.google.com/file/d/1NMAUtzcoSLwmHt_r5TLWwB28QJDghi6Q/view
- ERAC. (2019). *Informal waste collection and recycling*. ECMI Kosovo. Retrieved from https://www.ecmikosovo.org/uploads/Informal_Waste_ENG.pdf
- European Commission. (2017). *A Comprehensive Assessment of the Current Waste Management Situation in South East Europe and Future Perspectives for the Sector Including Options for Regional Co-Operation in Recycling of Electric and Electronic Waste*. Luxembourg:: Publications Office of the European Union. Retrieved from https://ec.europa.eu/environment/enlarg/pdf/pilot%20waste/final_report_en.pdf
- European Commission. (2022). *Circular economy action plan: For a cleaner and more competitive Europe*. European Commission. Retrieved February 22, 2022, from https://ec.europa.eu/jrc/communities/sites/default/files/new_circular_economy_action_plan.pdf
- European Environment Agency. (2021). *Municipal waste management in Western Balkan countries - Country profile: Kosovo*. European Environment Agency - European Topic Centre on Waste and Materials in a Green Economy. Retrieved from <https://www.eea.europa.eu/themes/waste/waste-management/municipal-waste-management-country/kosovo-municipal-waste-factsheet-2021/>
- European Environmental Bureau. (2020). *Guidelines on Circular Economy for the Countries of the Western Balkans and Turkey*. Brussels: EEB - European Environmental Bureau.
- European Parliament. (2021). *Circular economy: definition, importance and benefits*. European Parliament. Retrieved from <https://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/economy/20151201STO05603/circular-economy-definition-importance-and-benefits>

- EY Global. (2021). *Why waste management can accelerate circular economy in Europe*. EY Global. Retrieved from https://www.ey.com/en_gl/eu-institutions/why-waste-management-can-accelerate-circular-economy-in-europe
- France 24. (2019). *In Kosovo, Roma's recycling work is unsung, underpaid*. France 24. Retrieved from <https://www.france24.com/en/20190929-in-kosovo-roma-s-recycling-work-is-unsung-underpaid>
- Gjoka, R. (2020). *Regional Circular Economy Country Specific Report*. EnvNet. Retrieved from <http://env-net.org/wp-content/uploads/2020/04/Circular-Economy-Regional-Report-2019.pdf>
- Hapçiu, A. (2019). *Circular Economy in Kosovo: Perceptions and knowledge of circular economy among Kosovars*. Kosova Live. Retrieved from https://kosovalive.org/wp-content/uploads/2020/12/CE_AnneaHapciu_English_For_Print.pdf
- INDEP. (2018). *Waste management in Kosovo: Identifying challenges in the sector*. Institute for Development Policy. Retrieved from https://indep.info/wp-content/uploads/2018/07/WM_ENG.pdf
- ITA. (2021). *Kosovo Waste Management and Recycling*. ITA - International Trade Administration. Retrieved from <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/kosovo-waste-management-and-recycling>
- Kabashi, F. (2021). *Current state of Waste Management in Kosovo 2021*. Wtert Germany GmbH. Retrieved from <https://www.wtert.net/paper/4412/Current-state-of-Waste-Management-in-Kosovo-2021.html>
- KEPA. (2018). *Municipal Waste Management in Kosovo*. Prishtinë: Kosovo Environmental Protection Agency / Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Retrieved from https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal_Waste_Managment_in_Kosovo_Status_Report_2018.pdf
- KEPA. (2020). *Kosovo Environment 2020 Report of environmental indicators*. KEPA - Kosovo Environmental Protection Agency. Retrieved from https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedishi_i_Kosov%C3%ABs_2020_Raport_i_treguesve_mjedishor%C3%AB_-_ANGLISHT.pdf
- KEPA. (2022). *Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë*. KEPA - Kosovo Environmental Protection Agency. Retrieved from <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Raporti%20per%20menaxhimin%20e%20mbeturinave%20komunale%202020.pdf>
- KOSID. (2017). *Menaxhimi i mbeturinave përmes Ekonomisë Cirkulare, zgjidhja kundrejt degradimit mjedishor*. KOSID - Kosovo Civil Society Consortium for Sustainable Development.
- Kryeziu, S. (2020). *Circular economy country specific report - Republic of Kosovo*. EnvNet. Retrieved from http://env-net.org/wp-content/uploads/2021/03/Circular-Economy-Status-Report_ATRC_Kosovo.pdf

Salgado, L. (2011). *Washoe County Solid Waste Management Plan*.

Schmitz, H. (2005). *Value chain analysis for policy-makers and practitioners*. Geneva: International Labour Organization.

The Prime Minister Office. (2022). *Government approves the Economic Reforms Program 2022-2024*. The Prime Minister Office. Retrieved from <https://kryeministri.rks-gov.net/en/government-approves-the-economic-reforms-program-2022-2024/>

USAID. (2018). *Turning trash into treasure!* USAID. Retrieved from <https://www.usaid.gov/kosovo/news/turning-trash-treasure>

USAID. (2021). *Private sector leading the charge for a greener Kosovo*. USAID. Retrieved from <https://www.usaid.gov/kosovo/news-information/news/private-sector-leading-charge-greener-kosovo>

13. Aneksi

a. Aneksi 1: Anketa e riciklimit

Fillimi i bllokut: PËR ANKETUESIN DHE KOMPANINË

P1 Emri i kompanisë

Emri i kompanisë (4) _____

Përfaqësuesi i biznesit (5) _____

Emaili (6) _____

P2 Emri i anketuesit

Zgjedh emrin tënd (4)



Fundi i bllokut: PËR ANKETUESIN DHE KOMPANINË

Fillimi i bllokut: INFORMATA PËR TË ANKETUARIN

P3 Cila është pozita juaj në oranzatë?

1. Sipërmarrës/pronar (1)

2. Menaxher (CEO) (2)

3. Menaxher i burimeve njerëzore (3)

4. Tjetër (specifikoni) (4) _____

P4 Cili është niveli juaj i edukimit?

1. Më pak se fillor (1)

2. Shkolla fillore (2)

3. E mesme e përgjithshme (3)

4. E mesme profesionale(VET) (4)

5. Diplomë Universitare apo më lartë (5)

Fundi i bllokut: INFORMATA PËR TË ANKETUARIN

Fillimi i bllokut: RRETH KOMPANISË

P5 Në cilin vit është themeluar kompania juaj? (p.sh. 1995).

Viti (1)



P6 Në cilën komunë gjendet kompania juaj?

Komuna(1)



P7 Sa kompani operojnë në këtë sektor sipas njohurive tuaja? (Shkruani numrin)

Q8 Numri total i punëtorëve(tani) – përfshirë numrin e punëtorëve me gjysmë orari/orarë të plotë/të përhershëm/të përkohshëm?

	2019	2022	Numri i pritshëm i punëtorëve në tre vitet e ardhshme (në total)
	Nr i punëtorëve (1)	Nr i punëtorëve (1)	Nr i punëtorëve (1)
Punëtorët me orar të plotë (1)			
Punëtorët me gjysmë orar/sezonal (2)			

P9 Brenda vitit të kaluar, shitjet në kompaninë tuaj janë?

- Rritur (1)
- Qëndruan njejtë (2)
- Ulur (3)



P10 Nëse shitjet në kompaninë tuaj janë ngritur ose ulur, cili është ndryshimi në përqindje? Shkruani numrin.

P11 A keni investuar në vitin 2021?

- Po (1)
- Jo (2)

Shfaq këtë pyetje:

If A keni investuar në vitin 2021? = Po



P12 Nëse po, sa është vlera e përafërt në Euro?

Shfaq këtë pyetje:

If A keni bërë investime në vitin 2021? = Yes

P13 Në cilat nga fushat e mëposhtme ka investuar kompania juaj në tre vitet e kaluara? (mund të përdoret më shumë se një opsion)

Ndërtime (5)

Përmirësim të linjës aktuale të prodhimit (6)

Linjë e re prodhimi (7)

Të tjera (specifikoni?) (8) _____

P14 Në cilën nga fushat e mëposhtme planifikoni të investoni në 3 vitet e ardhshme ?

Asnjë investim (7)

Ndërtime (8)

Njohuri (1)

Pajisje/makineri (4)

Linjë e re prodhimi (5)

Të tjera (ju lutem specifikoni?) (6) _____

P15 Në 5 vitet e ardhshme, a pritni që shitjet në kompaninë tuaj të ?

Rriten (1)

Qëndrojnë njëjtë (2)

Ulen (3)

P16 Në 5 vitet e ardhshme, a pritni që sektori në të cilin ju funksiononi të ?

Rritet (1)

Qëndron njëjtë (2)

Ulet (3)

P17 Në cilin treg ndërmarrja juaj ka shitur pjesën më të madhe të mallrave dhe/ ose shërbimeve gjatë këtyre dy viteve të fundit ?

Vendorë ose kombëtar (1)

Vendet fqinje (2)

Vendet e BE-së (3)

Vende të tjera (Ju lutem shkruani vendin?) (4) _____

P18 Nëse kompania juaj eksporton, cila është përqindja e shitjeve totale nga eksporti ? (Vetëm për kompanitë eksportuese)

Ju lutem shkruani përqindjen (1) _____

P19 Në sa lokacione ka funksionuar kompania juaj që nga 30 dhjetori 2021?

1 lokacion (1)

2 lokacione (2)

3-5 lokacione (3)

Më shumë se 5 lokacione (4)

Fundi i bllokut: RRETH KOMPANISË

Fillimi i bllokut: PJESA 3:RRETH AKTIVITETEVE TË RICIKLIMIT

P20 A kryen ndërmarrja juaj ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme (ju lutem zgjidhni të gjitha ato që përdorni?)

	Po (1)	Jo(2)
Blen mbetje nga sektori jo formal (1)		
Blen mbetje nga sektori formal (2)		
Grumbullon mbetje nga qendra/sistemi i saj grumbullues (3)		
Blen mbetje jashtë Kosovës (4)		
Blen materiale ricikluese jashtë Kosovës (5)		
Klasifikon në burim (6)		
Klasifikon në mënyrë manuale mbetjet e përziera (7)		
Klasifikon mbetjet e përziera me makineri të linjës së klasifikimit (8)		
Pastrim (9)		
Depositim, garanci (10)		
Thekim/copëtim (11)		
Grimcim (12)		
Të tjera, specifikoni (13)		
Recikluesit(14)		
Tregu vendor (15)		
Eksporti (16)		

P21 Nga e kanë burimin mbetjet tuaja?

	Çfarë burime të mbetjeve përdorni?	Përqindja e mbetjeve për secilin burim?
	Shënoni atë që e përdorni (1)	% (1)

Nga mbledhësit e mbetjeve(1)		
Nga grumbulluesit komunal (2)		
Direkt nga prodhuesit industrial (3)		
Nga tregëtar të tjerë të mbeturinave (4)		
Infrastruktura vetëgrumbulluese (5)		
Importi (6)		
Të tjera (specifikoni?) (7)		

P22 Matja e përqindjes së burimeve të mbetjeve në tre vitet e ardhshme?

Nga mbledhësit e mbetjeve : _____ (1)

Nga grumbulluesit komunal : _____ (2)

Direkt nga prodhuesit industrial : _____ (3)

Nga tregëtar të tjerë të mbeturinave : _____ (4)

Infrastruktura vetëgrumbulluese : _____ (5)

Importi : _____ (6)

Të tjera (specifikoni?) : _____ (7)

Totali : _____

P23 Çfarë lloje mbetjesh të mbeturinave bleni? Shkruani të gjitha ato që i përdorni.

	Sasia në ton për vitin 2019 (1)	Sasia në ton për vitin 2021 (2)	Planet për blerje të mbetjave për vitin 2022 (3)
Organike (1)			
Polietileni tereftalat [PIC 1] (2)			
Polietileni me densitet të lartë [PIC 2] (3)			
Polietileni me densitet të ulët [PIC 4] (4)			
Polipropileni [PIC 5] (5)			
Polistireni [PIC 6] (6)			
Plastikat e përziera dhe/ose të tjera [PIC 7] (7)			
Çeliku (8)			
Metalet me ngjyra (9)			

Alumini (10)			
Karton & Letër (11)			
Qelqi (12)			
Mbetjet elektronike (13)			
Masoneri/muratori(14)			
Të tjera (ju lutem specifikoni?) (15)			



P24 Ku i shitni materialet e riciklueshme (produktet përfundimtare të bazuara në riciklim) ? Ju lutem ofroni përqindje për secilin konsumator tuajin ?

Tregun e shitjes me shumicë : _____ (1)

Tek tregëtarët ose ndërmjetësuesit e llojeve të vetme të materialeve të mëdha : _____ (2)

Direkt tek prodhuesit në Kosovë : _____ (3)

Direkt tek prodhuesit jashtë Kosovës: _____ (4)

Të tjera (ju lutem specifikoni) : _____ (5)

Totali: _____




P25 Sa është kapaciteti i prodhimit për muaj në ton?

P26 Sa është përqindja e përdorimit të kapacitetve nga 0 deri në 100 ?

0 10 20 30 40 50 60 70 80 90 100

% e kapaciteteve të përdorura ()



End of Block: SECTION 3: ABOUT RECYCLING ACTIVITIES

Start of Block: Barriers to expansion and growth

P27 A keni plane ose strategji për zgjerim të biznesit ?

Po (15)

Jo (16)

P28 A keni burime njerëzore të mjaftueshme dhe të afta për të vepruar në tregun e riciklimit ?

Nuk pajtohem aspak (13)

Nuk pajtohem deri diku (14)

As pajtohem as nuk pajtohem (15)

Pajtohem disi (16)

Pajtohem plotësisht (17)

P29 Deri në çfarë mase janë të parashtruara barrierat e mëposhtme për zgjerimin e biznesit tuaj?

	Nuk pajtohem aspak (1)	Nuk pajtohem deri diku (2)	As pajtohem as nuk pajtohem (3)	Pajtohem disi (4)	Pajtohem plotësisht(5)
Disponueshmëria e fuqisë punëtore(1)					
Pajisje/ makineritë (2)					
Financat (3)					
Korniza ligjore (4)					
Taksat (5)					
Barriera ndërkufitare (doganat) (6)					
Të tjera, ju lutem specifikoni? (7)					

P30 A keni marrë ndonjëherë ndonjë përkrahje nga ndonjë donator?

PO (1)

JO (2)

Fundi i bllokut: Barrierat për rritje dhe zgjerim

Fillimi i bllokut: ANTARËSIMI NË SHOQATËN E BIZNESIT

P31 A jeni antarë i ndonjë shoqate biznesi ?

PO (1)

JO (2)

P32 A dëshironi të jeni antarë i Shoqatës së Kompanive të Riciklimit nën ombrellën e Odës Ekonomike të Kosovës ?

PO (8)

JO (9)

P34 Çfarë llojë përkrahje prisni nga shoqata e kompanive të riciklimit brenda Odës Ekonomike ?(Mund të zgjedhni më shumë se një opsion?)

	Shënoni të gjitha ato që zbatohen (1)
Lobim dhe përkrahje(1)	
Trajnim (2)	
Rrjetëzim (p.sh., Pjesëmarrja në panaiet tregëtare, evente të investimeve) (3)	
Njohuri/Shërbime konsultuese (4)	
Të tjera, (ju lutem specifikoni) ? (5)	

Fundi i bllokut: ANTARËSIMI NO SHOQATËN E BIZNESIT

Fillimi i bllokut: MBROJTJA E MJEDISIT DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE

P35 A aplikon kompania juaj ndonjë standard të kualitetit për të siguruar mbrojtje të ambientit?

Jo (1)

Po (2)

Shfaq këtë pyetje:

If A aplikon kompania juaj ndonjë standard të kualitetit për të siguruar mbrojtje të ambientit = Po

P36 Nëse po, cilat janë ato sandarde të kualitetit (ju lutem shkruani emrin ?)

P37 A e njihni konceptin e ekonomisë qarkore?

Nuk e njohë (1)

E njohë (2)

E njohë shumë mirë (3)

P38 Sa është i rëndësishëm implementimi i praktikave të Ekonomisë Qarkore për të reduktuar përdorimin e lëndës së parë , energjisë dhe ujit?

Aspak i rëndësishëm (1)

Pak i rëndësishëm (2)

Mesatarishtë i rëndësishëm (3)

Shumë i rëndësishëm (4)

Jashtëzakonishtë i rëndësishëm (5)

Fundi i bllokut: MBROJTJA E MJEDISIT DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE